EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5712
E mërkurë, 27 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Ndryshimi i kufijve në Ballkan, agjendë e Putinit

FAQE 3

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR 'EPOKËN E RE', BILALL SHERIFI FAQE 4-5



NISMA PËR KËTA PESË VJET ARSYETOI THEMELIMIN E VET

- Bashkimi politik për taksën do ta zmbrapste presionin sikurse ka ndodhur me "Trepçën"

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka bërë me dije se kjo parti politike gjatë pesë vjetëve të ekzistencës së vet ka arsyetuar themelimin e vet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", me rastin e pesëvjetorit të themelimit të Nismës, ai ka thënë se para dhe pas themelimit ky subjekt politik është përballur me pengesa të ndryshme. Sherifi e ka ftuar spektrin politik për bashkim në çështjen e taksës ndaj produkteve serbe, duke theksuar se taksa as nuk duhet të hiqet e as të suspendohet. Sipas Sherifit, bashkimi politik për taksën do ta zmbrapste presionin sikurse ka ndodhur me "Trepçën"

KDI-ja: QYTETARËT DUAN RAPORTE TË MIRA ME NDËRKOMBËTARËT DHE TAKSË PËR SERBINË

FAQE 7

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shpalosur dy skenarë, duke përfshirë efektet e tyre pozitive dhe negative në rast të mbajtjes apo pezullimit të taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Qytetarët do ta mirëprisnin ruajtjen e raporteve të mira me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me ShBA-në. Në anën tjetër, pezullimi i takës do të ndikonte në rënien e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës

Lluka: Në fund të vitit 2019 Telekomi do të jetë gati për privatizim

FAQE 9

AKTUALE

THAÇI: VRASËSIT E VËLLEZËRVE BYTYÇI JANË NË INSTITUCIONET MË TË LARTA TË SERBISË

F. 6

U NDAHEN NGA 5 000 EURO SHOQATAVE TË FAMILJEVE TË PERSONAVE TË PAGJETUR

F. 3

MUSTAFA: VEPRIMET E SERBISË TREGOJNË MOSGATISHMËRI PËR MARRËVESHJE ME KOSOVËN

F. 5

EKONOMI

REÇICA MERR KONFIRMIMIN E BANKËS BOTËRORE PËR MBËSHTETJE TË REFORMAVE TË MPMS-së

F. 8

SEKTORI PRIVAT, I SHQETËSUAR PËR RRITJEN E PAGAVE NË SEKTORIN PUBLIK

F. 8

SPORT

RAHOVECI NË FESTË, NIS 'FINAL 8' DHE PËRUROHET PALESTRA

F. 15

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pack: Nuk duhet lejuar ndryshimi i kufijve në Ballkan

Bruksel, 26 shkurt - Ish-deputetja e Parlamentit Evropian, Doris Pack, ka vlerësuar se nuk duhet lejuar ndryshimi i kufijve në Ballkan, marrë parasysh historinë e tij dhe periudhën e viteve '90. Në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë, Pack ka thënë se shumë politikanë të sotëm evropianë nuk kanë qenë pjesë e politikës në vitet '90, prandaj edhe nuk mund ta kuptojnë situatën apo edhe nuk e njohin atë. "Nëse jeni vërtet të vetëdijshëm se çfarë ka ndodhur vitet e kaluara në ato vende, atëherë nuk duhet të lejoni të ketë ndryshim të kufijve. Nëse kjo ndodh, atëherë shënon fillimin e fundit. Ne e dimë se çfarë ka ndodhur në këtë rajon. Shumë politikanë të sotëm evropianë nuk kanë qenë pjesë e politikës në vitet '90, prandaj edhe nuk mund ta kuptojnë situatën apo thjesht nuk e njohin atë. Por, ata që kanë njohuri se çfarë ka ndodhur aty, ata që e njohin rajonin dhe mentalitetin e tij, duhet të jenë shumë të kujdesshëm", ka thënë ajo.

Përveç të tjerash, Pack ka thënë se për të është e pakuptueshme se si presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, janë pro kësaj politike. "Ajo që po luhet tani nuk është në interesin e Kosovës. 95 për qind e qytetarëve të Kosovës janë kundër ndryshimit të kufijve. Shpresoj se zgjidhja do të gjendet, por jo në ndryshimin e kufirit", ka shtuar Pack.

Duke folur për ndikimin e Rusisë në rajon, ish-deputetja Pack, e cila njëherësh ka qenë edhe raportuese e Parlamentit Evropian për Bosnjë e Hercegovinën, ka thënë se Rusia nuk ka interes për t'i ndihmuar vendet e rajonit të Ballkanit.

Thellohen mospajtimet brenda koalicionit qeverisës

Përplasjet në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës, BDI dhe LSDM, e cila drejtohet nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kanë për bazë bllokimin e seancës gjatë fundjavës kur duhej të votohej heqja e imunitetit të deputetit të VMRO-DPMNE-së, Trajko Veljanovski

Shkup, 26 shkurt - Tensionet në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës po bllokojnë zbardhjen e ngjarjeve të dhunshme të 27 prillit, theksojnë njohësit e çështjeve politike në Maqedoninë e Veriut. Ata komentojnë mosmarrëveshjet mes partnerëve të koalicionit lidhur me mosheqjen e imunitetit të deputetit të VMRO-DPMNE-së, Trajko Veljanovski, i cili akuzohet për ngjarjet në Kuvend.

Përplasjet në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës, partisë shqiptare, Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) dhe Lidhjes Social Demokrate (LSDM), e cila drejtohet nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kanë për bazë bllokimin e seancës gjatë fundjavës kur duhej të votohej heqja e imunitetit të deputetit të VMRO-DPMNE-së, Trajko Veljanovskit.

Ish-kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Veljanovski, gjykohet me akuzën për organizimin e ngjarjeve të 27 prillit në kohën kur drejtonte seancën konstituive.

Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, fajin e ka adresuar në llogari të deputetit socialdemokrat Muhamed Zekiri pasi, siç është shprehur Xhaferi, është detyruar ta ndërpresë seancën për shkak të sjelljes së pahijshme të deputetit Zekiri.

Kryeparlamentari Xhaferi ka qenë i vendosur në qëndrimin e tyre, duke u shprehur se në asnjë mënyrë nuk është shkelur qëllimshëm afati për të votuar lidhur me heqjen apo jo të imunitetit për Veljanovskin.

Ndërsa deputetët e LSDM-së e kanë akuzuar BDI-në për një koalicion të fshehtë me VMRO-në për, siç janë shprehur, "mbrojtur krimin".

Gjatë së martës lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, tha se nuk ka përplasje të pazgjidhshme, por vetëm mosmarrëveshje për një çështje që pritet të zgjidhet.

Albert Musliu nga Instituti për Zhvillimin e Demokracisë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se është bërë e zakonshme që para proceseve zgjedhore të ashpërsohen raportet mes partnerëve të koalicionit qeverisës. Ai në këtë kontekst e sheh edhe zënkën e fundit në mes të BDI-së dhe LSDM-së. "Ne si shoqëri jemi mësuar që çdoherë kur ka zgjedhje, para mbajtjes së tyre, të kemi situata tensionuese në mes të partnerëve të koalicionit. Tani se ky tension a është mes partive politike apo bëhet fjalë për animozitet personal, është çështje që do ta zbardhë koha", thotë Musliu.

Por, Nikolla Dujovski, profesor universitar, thotë se partitë politike arrijnë të bëjnë koalicione nga më absurdet përmes kombinacioneve pothuajse të pamundura për, siç thotë ai, kur është në pyetje pengimi i drejtësisë dhe shtetit ligjor. "Të gjithë politikanët, të cilët në një mënyrë apo tjetër kanë marrë pjesë në këtë proces për marrjen e mandatit të deputetit Trajko Veljanovski, i cili gjatë ngjarjeve të dhunshme më 27 prill ka drejtuar seancën parlamentare, do të thosha janë politikanë që janë bashkuar kundër drejtësisë. Dhe për këtë duhet të vetëdijesohen si deputetët e Lidhjes Social Demokrate, po ashtu edhe ata të Bashkimit Demokratik për Integrim", thotë Dujovski, duke shtuar se edhe më banale është paraqitja e politikanëve nga të dy taborët që synojnë ta bindin opinionin se ata nuk janë fajtorë, por fajtorë janë deputetët e palës tjetër, ndërkohë që vazhdojnë të bashkëqeverisin.

Dujovski thotë se instalimi i politikave të ndëshkueshmërisë do t'i faturohet më së shumti BDI-së, megjithëse kosto do të duhet të paguajnë edhe socialdemokratët. Ndërkaq Albert Musliu thotë se, nëse nuk arrihet të menaxhohet konflikti në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës, atëherë menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale vendi mund të përballet me zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Opozita në protestë, Kuvendi në seancë

Tiranë, 26 shkurt - Derisa brenda Parlamentit deputetët e mazhorancës janë grumbulluar për ta zhvilluar seancën plenare, një grup mbështetësish të opozitës janë grumbulluar për të protestuar. Ashtu edhe siç pritej, kreu i PD-sw, Lulzim Basha, e ka marrë fjalën para protestuesve.

Kreu demokrat Lulzim Basha, në fjalën e mbajtur në protestë, bëri thirrje për largimin e kryeministrit Edi Rama. Ai u bëri thirrje forcave të policisë që t'i heqin kapelat dhe ta arrestojnë Ramën. "Arrestojeni, bëjeni detyrën tuaj! Arrestojeni para se ta bëjë populli", deklaroi Basha.

Basha theksoi se beteja e nisur nga opozita do ta çlirojë vendin nga krimi dhe korrupsioni. "Sovrani është populli shqiptar dhe jo kriminelët. Kjo është një betejë që do ta çlirojë vendin nga klika mafioze, duke çliruar zgjedhjet, duke çliruar vendin, do t'i çlirojë vogëlushët, teksa ndiejnë pamundësinë e prindërve për t'iu përgjigjur nevojave të tyre. Ky udhëtim do t'i çlirojë qytetarët dhe të gjithë socialistët e ndershëm", tha Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Haradinaj: Ndryshimi i kufijve në Ballkan, agjendë e Putinit

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të martën se hapja e çështjes së kufijve dhe territoreve në Ballkan është agjendë e presidentit rus Vladimir Putin. Ai ka thënë se Kosovës i duhet një garanci e fortë ndërkombëtare për njohje të shtetësisë së Kosovës nga ana e Serbisë si dhe përjashtim i mundësisë së ndryshimit të kufijve në Ballkan

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të martën pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës, se hapja e çështjes së kufijve dhe territoreve në Ballkan është agjendë e presidentit rus Vladimir Putin. Sipas tij, Kosovës i duhet një garanci e fortë ndërkombëtare për njohje të shtetësisë së Kosovës nga ana e Serbisë si dhe përjashtim i mundësisë së ndryshimit të kufijve në Ballkan. "Hapja e çështjes së kufijve dhe territoreve në Ballkan është pikërisht ajo që ne e dimë që është agjendë e Vladimir Putinit, pra për ta mbajtur Ballkanin hapur, sepse askush nuk garanton kur hapet një kufi çka ndodh më pas", është shprehur ai.

Sa i përket taksës prej 100 përqindësh që Qeveria e Kosovës ka vënë në produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, Haradinaj ka thënë se Kosovës i duhet një kontratë. "E kemi thënë edhe ne disa herë që edhe ne shpresojmë sa më shpejt të vijë dita kur do të anulohet taksa dhe hyjë në fuqi marrëveshja e tregtisë së lirë në mes të Kosovës dhe Serbisë, por për këtë nevojitet kontrata, kontrata pra me të gjithë kapitujt e vet për njohjen reciproke. Një kontratë që nuk bazohet në ndryshim të kufijve dhe të territoreve dhe që nuk merr për bazë një Republikë serbe apo një pushtet të tretë, Dodik Republikë, si jemi mësuar t'i themi", ka deklaruar Haradinaj.

Bashkimi Evropian ka kundërshtuar vendosjen e kësaj mase në importet e Serbisë dhe Bosnjës derisa Shtetet e Bashkuara kanë thënë se mospezullimi i taksës 100 për qind përbën qëndrim kundër interesave të ShBA-së. Së fundmi, si pasojë e mbajtjes së taksës, autoritetet amerikane kanë anuluar ftesat për 14 pjesëmarrës nga Kosova në tetë programe të Qendrës Evropiane për Studime të Sigurisë "George Marshall".

Tarifa është bërë pengesë e vazhdimit të dialogut për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pasi presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se ky proces nuk vazhdon pa heqjen e taksës në importet e Serbisë. Tarifa prej 100 përqindësh për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina është vendosur në nëntor të vitit të kaluar.

U ndahen nga 5 000 euro shoqatave të familjeve të personave të pagjetur

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Në hapje të mbledhjes së 91-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kryeministri Ramush Haradinaj i ka dëshiruar mirëseardhje në kabinetin qeveritar ministres së re në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Zhiviq. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj i ka dëshiruar suksese dhe përmbushje të detyrave në këtë pozitë ministres së re.

Po në këtë mbledhje Qeveria ka ndarë mjete financiare në vlerë prej 115 740 eurosh për Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, që do ta mundësojë funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së këtij komisioni.

25 170 euro janë ndarë për mbulimin e aktiviteteve që do të zhvillohen për Epopenë e Dukagjinit, sipas kërkesave të degëve të shoqatave të OVL të UÇK-së në Deçan, Pejë, Gjakovë dhe Istog dhe kërkesës së Bashkësisë Lokale Radec dhe Klubit të Boksit nga Peja.

Kabineti qeveritar ka shqyrtuar propozimin për ndarjen e mjeteve financiare për shoqatat e familjareve të të pagjeturve për mbulimin e shpenzimeve për aktivitete gjatë viti 2019. Qeveria ka vendosur që secila nga këto shoqata të mbështeten me nga 5 000 euro. Njëkohësisht, në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar është aprovuar edhe kërkesa e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përkatësisht Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për kompensimin e shtesave dhe stimulimit për vitin 2019, në shumën prej 171 864 eurosh.

Miratimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe vendimi për nënshkrimin e Deklaratës së Qëllimit për ndërprerjen e marrëveshjes për sigurime sociale në mes të Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës, si marrëveshje e marrë përsipër nga Republika e Kosovës me procesin e suksedimit të Marrëveshjeve Bilaterale të nënshkruara nga ish-RSFJ-ja me shtetet e tjera.

Nënshkrimi i kësaj deklarate hap mundësinë për nisje të negociatave për Marrëveshje të Sigurimeve Sociale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës.

Kabineti Qeveritar ka shqyrtuar kërkesën e kompanisë "Euromaks" nga Peja, me qëllim të përballjes me dëmet e shkaktuara nga zjarri në këtë kompani.

Kabineti ka vendosur që t'i rekomandojë kërkuesit dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që të ndiqen procedurat ligjore në kërkim të mbështetjes dhe ndihmës shtetërore.

Flet për "Epokën e re", Bilall Sherifi

Nisma për këta pesë vjet

- Bashkimi politik për taksën do ta zmbrapste presionin sikurse ka ndodhur me "Trepçën"

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka bërë me dije se kjo parti politike gjatë pesë vjetëve të ekzistencës së vet ka arsyetuar themelimin e vet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", me rastin e pesëvjetorit të themelimit të Nismës, ai ka thënë se para dhe pas themelimit ky subjekt politik është përballur me pengesa të ndryshme. Sherifi e ka ftuar spektrin politik për bashkim në çështjen e taksës ndaj produkteve serbe, duke theksuar se taksa as nuk duhet të hiqet e as të suspendohet. Sipas Sherifit, bashkimi politik për taksën do ta zmbrapste presionin sikurse ka ndodhur me "Trepçën"

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka deklaruar se rrugëtimi i këtij subjekti politik nuk ka qenë i lehtë. Në pesëvjetorin e themelimit të këtij subjekti politik ai ka thënë se Nisma ka arsyetuar themelimin e saj si parti politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sherifi ka deklaruar se ky subjekt politik para dhe pas themelimit është përballur me pengesa të ndryshme. "Themelimi i Nismës ka pasur për qëllim bashkimin rreth një subjekti të njerëzve të cilët nuk pranojnë t'i nënshtrohen individit. Bashkimin e njerëzve të cilët refuzojnë të udhëhiqen nga mendësia autoritare e drejtuesve të partisë. Bashkimin e njerëzve të cilët i ndajnë vlerat e përbashkëta kombëtare dhe socialdemokrate. Kur shohim aktivitetin e zhvilluar gjatë këtyre pesë vjetëve besojmë se kemi arritur ta justifikojmë themelimin e Nismës Socialdemokrate!", ka thënë Sherifi. Ai ka treguar se kjo parti politike ka bërë punë të mira edhe në qeveri, në dikasteret që drejton. "Megjithatë, për një periudhë prej pothuajse një vit e gjysmë sa jemi në qeveri, përmes kryetarit Limaj si zëvendëskryeministër dhe tri ministrive që drejtojmë, kemi arritur të bëjmë punë të mira për shtetin tonë dhe qytetarët tanë. Besojmë se deri në fund të mandatit të qeverisë do të arrijmë ta zbatojmë programin zgjedhor në një masë bukur të madhe", ka thënë Sherfi.

Shefi i grupit parlamentar i Nismës e ka ftuar spektrin politik për bashkim për çështjen e taksës dhe në procesin e dialogut me Serbinë. Sipas tij, taksa dhe dialogu me Serbinë nuk duhet të ndërlidhen njëra me tjetrën. Ai ka thënë se bashkimi politik për taksën do ta zmbrapste presionin sikurse ka ndodhur me "Trepçën". "Jemi dëshmitarë se sa shpejt u tërhoqën nga kërkesa që për çështjen e 'Trepçës' të bisedohet në Bruksel. Kjo ndodhi vetëm për shkak të reagimit të përbashkët të të gjithë spektrit politik, pra të pozitës dhe opozitës. Kam bindjen se edhe kërkesat për heqjen e taksës/tarifës do të kishin pasur të njëjtin fat po sikur të gjithë njëzëri të mos kishim pranuar që vazhdimi i dialogut të kushtëzohet as me suspendim dhe as me heqje të taksës", është shprehur Sherifi.

"Epoka e re": *Z. Sherifi, Nisma Socialdemokrate tani po i mbush pesë vjet si subjekt politik. Si do ta përshkruani rrugëtimin e saj politik?*

Sherifi: Po, më 28 shkurt të këtij viti bëhen pesë vjet nga themelimi Nismës për Kosovën. Siç e di edhe publiku i gjerë, vitin e kaluar mbledhja e Këshillit Kombëtar ia

arsyetoi themelimin e vet

ndryshoi emrin në Nisma Socialdemokrate. Rrugëtimi pesëvjeçar i Nismës nuk ka qenë i lehtë, përkundrazi ka qenë shumë i vështirë. Nisma jo vetëm në fillimet e saj, por edhe më pas është përballur me pengesa nga të ndryshme. Megjithatë, pavarësisht prej tyre, arriti të shndërrohet në forcë politike parlamentare. Në frymën e premtimeve parazgjedhore, se do të angazhohemi për ta bërë ndryshmin në qeverisjen e vendit, përkundër ofertave të mëdha, Nisma nuk pranoi të bëhet pjesë e qeverisë, sepse kjo do të thoshte vazhdim i keqqeverisjes dhe jo ndryshim. Madje Nisma ishte edhe nismëtare e krijimit të opozitës së bashkuar pas zgjedhjeve të vitit 2014 LDK-AAK-Nisma, së cilës pastaj iu bashkua edhe LV-ja. Në të gjitha zhvillimet e kohës sa ishim në opozitë kontributi i Nismës ka qenë shumë i madh. Madje e them me bindje të plotë se pa rolin konstruktiv të themeluesve dhe drejtuesve të Nismës, Jakup Krasniqi dhe Fatmir Limaj, nuk do të kishte as opozitë të bashkuar.

"Epoka e re": *Cila mendoni se ka qenë risia që kjo parti ka sjellë në skenën tonë politike?*
Sherifi: Themelimi i Nismës ka pasur për qëllim bashkimin rreth një subjekti të njerëzve të cilët nuk pranojnë t'i nënshtrohen individit. Bashkimin e njerëzve të cilët refuzojnë të udhëhiqen nga mendësia autoritare e drejtuesve të partisë. Bashkimin e njerëzve të cilët i ndajnë vlerat e përbashkëta kombëtare dhe socialdemokrate. Kur shohim aktivitetin e zhvilluar gjatë këtyre pesë vjetëve besojmë se kemi arritur ta justifikojmë themelimin e Nismës Socialdemokrate.

"Epoka e re": *Po bëhen gati dy vjet që Nisma e ka sprovuar vetën në qeverisje, duke drejtuar disa ministri. Sa po arrin kjo parti ta realizojë misionin e vet politik?*
Sherifi: Të qenurit në pushtet është sfidë kudo në botë, mirëpo të qenurit në pushtet në Kosovë, ku nevojat e njerëzve janë jashtëzakonisht të mëdha, ndërsa mundësitë e kufizuara, të qenurit në pushtet e bën sfidën shumë më të madhe. Megjithatë, për një periudhë prej pothuajse një vit e gjysmë sa jemi në qeveri, përmes kryetarit Limaj si zëvendëskryeministër dhe tri ministrive që drejtojmë, kemi arritur të bëjmë punë të mira për shtetin tonë dhe qytetarët tanë. Besojmë se deri në fund të mandatit të qeverisë do të arrijmë ta zbatojmë programin zgjedhor në një masë bukur të madhe.

"Epoka e re": *Së fundi koalicioni qeverisës nuk po flet me një zë rreth taksës ndaj produkteve serbe. Cili është qëndrimi i Nismës rreth këtij çështje?*
Sherifi: Taksa/tarifa ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës është vendosur si reagim ndaj agresionit të vazhdueshëm të Serbisë kundër shtetit të Kosovës. Ky vendim i qeverisë është marrë në përputhje të plotë me interesat e shtetit tonë dhe në unitet të plotë të partnerëve të koalicionit qeverisës. Taksa duhet të trajtohet ndaras nga dialogu. Kushdo që e kushtëzon dialogun me heqjen/suspendimin e taksës bën gabim. Vendosja e taksës ka arsyet e veta, të cilat i përmenda më lart dhe, pa u hequr arsyet e vendosjes, ajo nuk duhet as të hiqet dhe as të suspendohet. Dialogu si proces ka arsyet e veta pse ka filluar prandaj, pavarësisht taksës, ai duhet të vazhdojë.

"Epoka e re": *A po i rrezikon taksa raportet e Kosovës me ShBA-të?*
Sherifi: E kam thënë disa herë dhe po e përsërisë edhe në këtë intervistë. Raportet ShBA-Kosovë janë shumë të thella, shumë të gjithanshme, janë raporte që shkojnë përtej aleancave të zakonshme, përtej miqësisë së zakonshme mes dy popujve, janë raporte të mbrojtësit dhe të të mbrojturit. Prandaj nuk besoj se një veprim si ky i taksës/tarifës ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës mund të lëkundë raportet mes dy vendeve.

"Epoka e re": *Nëse kryeministri vazhdon të këmbëngulë në mbajtjen e taksës dhe PDK-ja në pezullimin e saj, cila duhet të jetë zgjidhja? Janë zgjedhjet e parakohshme, zgjidhje?*
Sherifi: Zgjidhja është ajo që thashë më lart. Dialogu dhe taksa të trajtohen veç e veç. Dialogu për marrëveshjen finale ligjërisht të obliguar për dy vendet në njërën anë dhe taksa si një çështje e veçantë që i ka arsyet e veta pse është vendosur në anën tjetër. Këto dy çështje nuk duhet të shihen të ndërvarura me njëra-tjetrën, prandaj edhe nuk duhet të kushtëzohen me njëra-tjetrën. Procesi i dialogut me Serbinë të vazhdojë. Në funksion të kësaj, Kuvendi i Kosovës e ka zgjedhur ekipin shtetëror për bisedime me Serbinë dhe është në fazën përmbyllëse të miratimit të një platforme e cila besoj se shumë shpejt do të marrë edhe miratimin e Kuvendit. Zgjedhjet nuk janë zgjidhje për këtë situatë sepse, ta zëmë, për shkak të mospajtimeve për taksën/tarifën do të shkonte vendi në zgjedhje, taksa/tarifa do të mbetej në fuqi gjithsesi. Prandaj nuk mendoj se zgjedhjet janë zgjidhje. Zgjidhja është tek uniteti i klasës politike pozitë-opozitë dhe jo te përplasja me njëri-tjetrin. Jemi dëshmitarë se sa shpejt u tërhoqën nga kërkesa që për çështjen e Trepçës të bisedohet në Bruksel. Kjo ndodhi vetëm për shkak të reagimit unik të të gjithë spektrit politik qoftë pozitë, qoftë opozitë. Kam bindjen se edhe kërkesat për heqjen e taksës/tarifës do të kishin pasur të njëjtin fat po sikur të gjithë njëzëri të mos kishim pranuar që vazhdimi i dialogut të kushtëzohet as me suspendim dhe as me heqje.

Mustafa: Veprimet e Serbisë tregojnë mosgatishmëri për marrëveshje me Kosovën

Prishtinë, 26 shkurt (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka deklaruar se veprimet armiqësore të Serbisë në raport me shtetin e Kosovës tregojnë se ky shtet nuk është në linjë me kërkesën e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara për të arritur një marrëveshje përfundimtare me Kosovën. "Veprimet e Serbisë, sidomos fushata për ç'njohjen e pavarësisë së Kosovës nga disa vende, sikurse edhe fushata kundër Kosovës për anëtarësim në Interpol, flet se ky shtet fqinj nuk është i interesuar t'i normalizojë marrëdhëniet me vendin tonë e aq më pak ta njohë shtetin e Kosovës. Serbia po krenohet me dëmet që po na i shkakton në arenën ndërkombëtare", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka shtuar se politikat e fqinjësisë së mirë, paqes dhe stabilitetit, për të cilat janë zotuar vendet e Ballkanit Perëndimor, bien ndesh me një sjellje të tillë. "Kjo sjellje nuk ka asgjë të përbashkët edhe me kërkesën e BE-së dhe ShBA-së për arritjen e marrëveshjes përfundimtare, me njohje reciproke. Prandaj do të ishte mirë të lihet anash mentaliteti i trashëguar armiqësor dhe të punohet për të kultivuar një mjedis në të cilin punojmë për prosperitet të qytetarëve tanë", ka thënë Mustafa.

Kosova ka treguar rezultate të mëdha në luftën kundër terrorizmit

Shkup, 26 shkurt (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka marrë pjesë në konferencën e ministrave nga "Procesi i Brdos" e cila po mbahet në Shkup, nikoqire e së cilës është Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Temë kryesore e kësaj konference ishte vlerësimi i zbatimit të deritanishëm të iniciativës për përmirësimin e integrimit të sigurisë së brendshme. Me këtë rast, ministri Mustafa ka thënë se mekanizmi i qeverisjes integruese të sigurisë së brendshme është duke treguar në vazhdimësi rezultate konkrete dhe të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor. "Ky mekanizëm ka arritur ta përmirësojë koordinimin e veprimeve të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe donatorëve të ndryshëm të pranishëm në rajonin tonë, duke zvogëluar mbivendosjen apo duplifikimin e veprimeve", ka thënë ministri Mustafa, duke theksuar se koordinimi i donatorëve mbetet ende sfidë me të cilën secili nga shtetet përballet dhe duhen shtuar përpjekjet për ta rregulluar këtë fushë.

Pavarësisht prej progresit të arritur në rajon kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, krimeve të rënda dhe sigurisë kufitare, ministri Mustafa ka theksuar se ka ende shumë punë të bërë për t'i arritur standardet evropiane. Në fjalën e tij para ministrave, ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka pohuar se Kosova ka treguar rezultate të mëdha në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, të cilat janë pasqyruar edhe në raportet e Bashkimit Evropian. Ai ka bërë me dije se, përveç veprimeve efikase të agjencive të zbatimit

të ligjit, janë ndërmarrë masa të shumta parandaluese si themelimi i mekanizmave referues për rastet e radikalizmit dhe themelimit të Divizionit për Parandalim dhe Riintegrimin e Personave të Radikalizuar, të cilat po merren si shembuj nga shtetet e tjera.

Thaçi: Vrasësit e vëllezërve Bytyçi janë në institucionet më të larta të Serbisë

EPOKA E RE — Qendresa RAMA

Prishtinë, 26 shkurt - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka pritur Ilir Bytyçin, vëllanë e tre heronjve të Kosovës, Yllit, Agronit dhe Mehmet Bytyçit, pjesëtarë të Batalionit "Atlantiku", të vrarë nga forcat serbe. Presidenti Thaçi ka thënë se në shumë takime me përfaqësues ndërkombëtarë, krahas çështjes së pagjeturve, ka ngritur edhe vrasjen e tre vëllezërve Bytyçi. "Së fundmi këtë çështje e kemi diskutuar edhe me senatorë dhe kongresistë amerikanë, të cilët kanë bërë një punë të madhe për rritjen e presionit ndaj shtetit serb. Vrasësit e vëllezërve Bytyçi dihen me emër dhe mbiemër dhe janë të pozicionuar në institucionet më të larta të shtetit serb", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërsa Ilir Bytyçi në emër të familjes e ka falënderuar presidentin Thaçi për angazhimin e tij për këtë çështje. Ai ka theksuar se ngritja e kësaj çështje nga institucionet e Kosovës do ta rrisë presionin mbi Serbinë për ta ndriçuar këtë dhe rastet e tjera të luftës në Kosovë. Presidenti Thaçi edhe një herë ka shprehur përkushtimin e institucioneve të Kosovës për zbardhjen deri në fund të rastit Bytyçi dhe sjelljen e krimineleve para drejtësisë.

Edhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj e ka pritur në takim Ilir Bytyçin. Hoxhaj ka thënë se ShBA-ja, familja Bytyqi dhe Kosova kanë bërë çmos për t'i sjellë para drejtësisë autorët e vrasjes të cilët, fatkeqësisht, ende vazhdojnë të mbrohen nga shteti. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka bërë me dije se me Ilir Bytyqin kanë diskutuar për një sërë hapash të koordinuar në javët e ardhshme për ta risjellë edhe një herë në vëmendjen e botës këtë rast dhe duke theksuar se ka kërkuar drejtësi për ta.

Ministri Ismaili: Do të fillojmë një studim për shëndetin parësor

Prishtinë, 26 shkurt - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se do ta fillojnë studimin lidhur me shëndetin parësor në të gjitha komunat. Ai ka thënë se pas këtij studimi do ta hartojnë Planin strategjik dhe përgatitjen e listave të pacientëve të cilat tregojnë se sa pacientë trajtohen nga një mjek. Ismaili ka theksuar se raportet që ka pranuar nga qendrat mjekësore të komunave kishin rezultate të ndryshme në infrastrukturë, kontrolle dhe shërbime. "Nga ky raport do të mund të krijohet një vizion i përbashkët i bashkëpunimit si dhe të ketë sa më shumë transparencë për ndarjen e buxhetit", ka thënë Ismaili në një takim me kryetarët e komunave të Kosovës.

Ndërsa kryetari i Asociacionit të Komunave, Agim Veliu, ka deklaruar se ngritja profesionale ka rëndësi të madhe për rritjen e cilësisë në shëndetësi. Ndërsa ambasadori i Zvicrës për Kosovë, Jean Hubert Lebet, ka thënë se kujdesi parësor shëndetësor është i rëndësishëm pasi, sipas tij, është kontakti i parë me qytetarët.

KDI-ja: Qytetarët duan raporte të mira me ndërkombëtarët dhe taksë për Serbinë

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shpalosur dy skenarë, duke përfshirë efektet e tyre pozitive dhe negative në rast të mbajtjes apo pezullimit të taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Qytetarët do ta mirëprisnin ruajtjen e raporteve të mira me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me ShBA-në. Në anën tjetër, pezullimi i takës do të ndikonte në rënien e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 SHKURT - Jeta Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) gjatë konferencës për media ka thënë se kjo analizë tenton t'i japë publikut një pasqyrë më të gjerë të efekteve që "pezullimi" apo "mbajtja" e taksës do të prodhonte në disa dimensione, së pari në procesin e dialogut Kosovë - Serbi, pastaj në marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë, në zhvillimet e brendshme politike në vend, në ekonomi dhe përfundimisht në percepcionin qytetar.

Eugen Cakolli nga KDI-ja, gjatë prezantimit të skenarit të parë, ka theksuar se mbajtja e taksës prej 100 përqindësh shpërfaqi marrëdhëniet reale midis Kosovës dhe Serbisë dhe faktin sa larg janë palët nga normalizimi, përderisa efektet kryesore pozitive ishin ushtrimi i sovranitetit shtetëror të Kosovës në raport me Serbinë, kthimi i vëmendjes te niveli i zbatimit të marrëveshjeve të dialogut dhe mundësia e Kosovës për të imponuar tema relevante në dialog.

Si efekt negativ u përmend kushtëzimi i Serbisë për ta vazhduar dialogun dhe, rrjedhimisht, fuqizimin e pozitës së saj në raport me bashkësinë ndërkombëtare. "Në lidhje me raportet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë, si faktor pozitiv u evidentua të jetë rritja e nivelit të përfshirjes së ShBA-së në procesin e dialogut, ndërsa si efekt negativ u tha të jetë lëkundja e mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë ndaj Kosovës, e cila është manifestuar nëpërmjet masave dhe veprimeve të ndryshme ndëshkuese", ka thënë ai.

Cakolli, duke folur për ndikimet në aspektin e brendshëm politik, argumentoi se efekt pozitiv është konsideruar nxitja e debatit për nevojën e një konsensusi shtetëror dhe krijimin i hapësirës kohore për ndërtimin e qëndrimit zyrtar të Kosovës lidhur me procesin e dialogut.

Ndërsa efektet negative i atribuohen polarizimit midis institucionit të presidentit, qeverisë, partnerëve të koalicionit qeverisës dhe subjekteve të tjera politike, si dhe tkurrja e politikës së jashtme të Kosovës vetëm lidhur me çështjet e taksës dhe dialogut. "Në aspektin ekonomik, efekti kryesor pozitiv vlerësohet të jetë rritja e konsumit të produkteve vendore, ndërsa si efekte negative u listuan rritja e çmimeve të produkteve të caktuara dhe kontrabandës. Rritja e dinjitetit shtetëror u vlerësua të jetë ndikim pozitiv te qytetarët lidhur me mbajtjen e taksës prej 100 përqindësh, ndërsa rritja e shqetësimit qytetar për humbjen e përkrahjes nga partnerët ndërkombëtarë u cilësua një nga efektet kryesore negative në skenarin e mbajtjes së taksës", plotësoi tutje ai.

Në skenarin e dytë "pezullimi i taksës prej 100 përqindësh", për dallim nga skenari i parë ku efektet pozitive janë dukshëm më të theksuara në planin politik të brendshëm në Kosovë, efektet pozitive do të shiheshin në sferën e marrëdhënieve të Kosovës me partnerët ndërkombëtarë.

Sipas Jeta Krasniqit, efekti kryesor pozitiv i pezullimit të taksës do të ishte vazhdimi i dialogut dhe forcimi i pozitës negociuese në raport me Serbinë, gjithsesi efekt negativ do të ishte vazhdimi i dialogut pa një qëndrim të përbashkët në mes të spektrit politik në Kosovë si dhe rreziku i arritjes së një marrëveshje që mund të paraqesë kompromis të pafavorshëm për Kosovën.

Ajo ka shtuar se në planin e jashtëm pezullimi i taksës do t'i përmirësojë raportet në mes të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë, kurse si efekt negativ u vlerësua presioni që partnerët ndërkombëtarë do të mund të ushtronin për arritjen e një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë brenda një afati kohor artificial, duke mos i kushtuar vëmendje përmbajtjes së marrëveshjes përfundimtare. "Mundësia për unifikim të qëndrimit nga spektri politik dhe institucionet, artikulimi i kërkesave të qarta të Kosovës ndaj partnerëve ndërkombëtarë për garancitë që duhet të ofrohen në kuadër të dialogut, u thanë të jenë efektet kryesore pozitive. Kurse si efekt negativ u vlerësua të jetë përçarja e spektrit politik lidhur me qasjen që Kosova duhet të ketë ndaj Serbisë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve.

Në planin ekonomik, pezullimi i taksës do të prodhonte efekt pozitiv për rritjen e të hyrave doganore, ndërsa do ta ulte nivelin e konsumit të prodhimeve vendore", ka thënë ajo.

Qytetarët do ta mirëprisnin ruajtjen e raporteve të mira me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me ShBA-në. Në anën tjetër, pezullimi i takës do të ndikonte në rënien e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës. Këta skenarë janë realizuar duke marrë parasysh faktin që deri më tani, pavarësisht prej qëndrimeve dhe diskursit politik aktual, janë dhënë pak argumente mbi përparësitë dhe mangësitë e opsionit të mbajtjes së taksës prej 100 përqindësh dhe opsionit për pezullimin e saj.

Besnik Tahiri me përfaqësuesit e Bankës Botërore diskutoi për reformat shtetërore

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Koordinatori Nacional i Reformave Shtetërore, Besnik Tahiri, ka pritur të martën në takim një delegacion të Bankës Botërore nga Uashingtoni dhe zyra në Kosovë, me të cilët ka diskutuar për reformat shtetërore, me theks të veçantë Ligjin për Qeverinë dhe atë të reformave në fushën e inspektimeve. "U zotova se të dy këto procese do t'i përmbyllim deri në qershor 2019 në një proces të hapur dhe mirë të konsultuar me të gjithë aktorët politikë dhe shoqërinë civile", ka thënë Besnik Tahiri pas përfundimit të këtij takimi.

Reçica merr konfirmimin e Bankës Botërore për mbështetje të reformave të MPMS-së

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të martën në takim përfaqësues të Bankës Botërore, të kryesuar nga Stefanie Brodman, me të cilët ka biseduar për një varg çështjesh të ndërlidhura me reformat e ndërmarra nga MPMS.

Brodman ofroi edhe një herë mbështetjen e Bankës Botërore për MPMS-në në përpjekjet e saj për ngritje të përgjithshme të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Ministri Reçica falënderoi Brodman për përkrahjen duke thënë se reformat që ka nisur MPMS vitin e kaluar kanë për qëllim ngritjen e mirëqenies së përgjithshme të shumë kategorive të shoqërisë, andaj mbështetja nga partnerët, siç është Banka Botërore, është e rëndësisë së veçantë. Të dyja palët u pajtuan për konkretizim të hapave në vijim në kuadër të mbështetjes së ofruar nga Banka Botërore.

SEKTORI PRIVAT, I SHQETËSUAR PËR RRITJEN E PAGAVE NË SEKTORIN PUBLIK

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, ka bërë me dije se kompani të ndryshme në vend janë të shqetësuara për çështjen e pagave, pasi rritja e pagave në sektorin publik këto kompani i ka nxjerrë në pozita më të vështira

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka hapur të martën mbledhjen e dhjetë të Këshillit Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik, në të cilën janë trajtuar shumë tema, në veçanti përkrahja e bizneseve. Ministri Shala ka theksuar se do të vazhdojnë ta forcojnë Këshillin, duke e konsideruar si një platformë të dobishme për dialog. "Ne do të vazhdojmë ta forcojmë këtë Këshill si një platformë të dobishme të dialogut publiko-privat, ku do t'i adresojmë prioritetet dhe sfidat kryesore për t'i zbatuar reformat gjithëpërfshirëse e që do të ndikojnë në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në Republikën e Kosovës", ka thënë ministri Shala.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka theksuar se nuk ka dilemë që pa një koordinim të përbashkët dhe pa rolin e secilit prej nesh, do të jetë e vështirë të sigurohet një agjendë e mirëfilltë e zhvillimit ekonomik. Kryeministri Haradinaj ka thënë se nga takimi i kaluar i nivelit të tillë u vlerësua se takimi i radhës të mbahet para përfundimit të këtij muaji, në mënyrë që të sigurohet një vazhdimësi e atyre obligimeve dhe u dha një garanci që do të ketë sekretariat.

Kryeministri Haradinaj ka shtuar se nga vizita me përfaqësues të kompanive të ndryshme ka marrë kërkesa të ndryshme, si periudha e investimeve ku nuk paguhet tatim, përkrahja financiare me rastin e hapjes së vendeve të punës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se sot është me rëndësi që të fokusohen në temat që janë më aktuale, por edhe me detyrat, ku parashihet zbatimi ose që janë më urgjente. Haradinaj i ka informuar të pranishmit se nga vizitat, kompani të ndryshme në vend janë të shqetësuara për çështjen e pagave, ngaqë rritja e pagave në sektorin publik i nxjerr ata në pozita më të vështira, duke theksuar se ato që i përmendi janë impute të tij për takimin e sotëm, por edhe për kohën që vjen. Në këtë takim u diskutuan edhe temat nga Oda Ekonomike e Kosovës, të tilla si trajtimi i çështjes së prokurimit publik, integrimi i mekanizmave alternativë, inicimi i analizës mbi implementimin e Ligjit mbi mbrojtjen e konsumatorit. Njëkohësisht u diskutuan tema për diskutim edhe nga Oda e Afarizmit e Kosovës si kërkesa për shfuqizim të Udhëzimit Administrativ nga Ministria e Bujqësisë, e cila ndikon sidomos në sektorin e minierave dhe mineraleve, rifunksionalizimi i Gjykatës Ekonomike për çështje të bizneseve.

Po ashtu, u diskutuan edhe tema nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për ZRRE-në, KEDS-in dhe si dhe disa tema të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si çështja e pronësisë së trafostacioneve dhe mënyra e rimbursimit të tyre.

BQK-ja dhe KfW-ja vazhdojnë bashkëpunimin

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka takuar të martën përfaqësuesit e Institutit Kreditor për Rindërtim (Kreditanstalt für Wiederaufbau: KfW) nga Gjermania, të cilët po qëndrojnë për vizitë në Kosovë. Guvernatori Mehmeti i ka informuar zyrtarët e këtij institucioni për gjendjen në sistemin financiar dhe i ka falënderuar përfaqësuesit e KfW-së për përkrahjen e vazhdueshme që kanë dhënë dhe po japin për zhvillimin e sistemit financiar, përkatësisht për përkrahjen e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK). Me këtë rast, Mehmeti ka deklaruar se sektori financiar ka pasur zhvillime pozitive, ku asetet e sistemit financiar kanë shënuar rritje vjetore prej 6.9 përqindësh, ndërsa kreditimi bankar ka shënuar rritje vjetore rreth 11 për qind, normat e interesit në kredi kanë zbritur në 6.3 për qind, ndërsa norma e kredive joperformuese ka shënuar rënie në 2.7 për qind.

Gjithashtu, guvernatori Mehmeti i ka njoftuar përfaqësuesit e KfW-së lidhur me zhvillimet pozitive edhe në sektorë të tjerë, si sektori i sigurimeve, pensioneve dhe ai i institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare. Po ashtu, Mehmeti ka informuar përfaqësuesit e KfW-së për aktivitetet e vazhdueshme të BQK-së për avancimin e mëtejmë të kornizës rregullatore të sistemit financiar, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare.

Ndërkaq përfaqësuesit e KfW-së, të kryesuar nga dr. Markus Aschendorf dhe Thomas Reker, kanë falënderuar guvernatorin Mehmeti për bashkëpunimin e vazhdueshëm. Ata theksuan se do të rritet edhe më tej bashkëpunimit ndërmjet KfW-së dhe BQK-së.

LLUKA: NË FUND TË VITIT 2019 TELEKOMI DO TË JETË GATI PËR PRIVATIZIM

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë të martën para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, se rikonstrukturimi i Telekomit të Kosovës do të marrë kohë gjashtë muaj. Ai ka bërë me dije se në fund të vitit 2019 Telekomi do të jetë gati për privatizim

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik. Ai ka konfirmuar se deri tash janë katër kompani të interesuara për privatizimin e Telekomit. Sa iu përket punësimeve të fundit në këtë ndërmarrje, ministri Lluka ka thënë se ato janë me kontratë mbi vepër. Sipas Llukës, numri i punëtorëve në Telekom ka arritur në 2 500. Ai është zotuar para anëtarëve të këtij komisioni se nuk do të lejojë asnjë kompani fantome të hyjë në procesin e Telekomit të Kosovës. "Ju siguroj se asnjë kompani fantome nuk do të marrë pjesë në procesin e privatizimit", ka deklaruar ai.

Sa i përket rikonstrukturimit të Telekomit të Kosovës, ai ka thënë se ky proces do të marrë kohë gjashtë muaj. Ministri Lluka ka thënë se në fund të vitit 2019 Telekomi do të jetë gati për privatizim. "Banka Evropiane, përveç rikonstrukturimit, e ka edhe përgatitjen për procesin e privatizimit. Privatizimi është i vetmi shpëtim për Telekomin. Rikonstrukturimi merr kohë gjashtë muaj dhe në fund të vitit 2019 do të hapet konkursi për privatizim", ka deklaruar Lluka. Ai ka thënë se menaxhmenti i Telekomit ka nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti me një nga kompanitë e interesuara për privatizimin e Telekomit, "Artillery One".

Ministri Lluka ka thënë se kjo marrëveshje i lejon kompanisë në fjalë qasje në veprimet që ndërmerr Telekomi, në mënyrë që kur të ofertojnë për privatizim, të dinë më mirë se çfarë do të blejnë. Ai ka theksuar se kompania "Artillery One" nuk ka marrëveshje me Qeverinë e Kosovës. "Tash se si ka ardhur që kjo kompani ka nënshkruar marrëveshje me Telekomin, këtu nuk ka punë qeveria. Pa u formuar komuniteti për privatizim nuk ka të drejtë askush të nënshkruajë marrëveshje të konfidencialitetit", është shprehur Lluka, duke shtuar se personeli i "Artillery One" e ka ofenduar atë pasi nuk ka lejuar qasje në të dhënat. 'Artillery One më ka ofenduar pasi që nuk i kam dhënë qasje ekskluzive për të dhëna dhe më ka thënë se jam ministër i papërgjegjshëm", u shpreh Lluka.

Ministri Lluka ka theksuar se dikasteri që ai drejton është shumë i preokupuar me gjendjen financiare të Telekomit pasi ka pasur disa humbje të mëdha të cilat e kanë provokuar gjendjen financiare të kësaj ndërmarrje. Ai ka thënë se që nga marrja e mandatit si ministër ka punuar për ta adresuar secilin problem të Telekomit. "Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar për përmirësimin e ndërmarrjes së Telekomit. Sa i përket vendimit të fundit, ky vendim është i përputhshëm dhe kërkon aprovimin e Kuvendit të Kosovës. Cilido rekomandim i komisionit do t'i paraprijë procesit të ristrukturimit të kësaj ndërmarrjeje", u shpreh Lluka.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se është shqetësues fakti se si nënshkruhen marrëveshje të tilla pa miratimin e dikasterit përkatës. Ndërkaq deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, e ka akuzuar ministrin Llukën se ai më shumë është zyrtar i Z- Mobile sesa ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Ismajli i ofron mbështetje stacionit policor në Shtime

Shtime, 26 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, ka pritur të martën në takim komandanten e Stacionit Policor në Shtime, togeren Feime Bajrami, dhe rreshterët Nexhmedin Ahmeti dhe Skender Ramusa.

Kryetari Ismajli ka falënderuar drejtuesit e stacionit policor në Shtime për bashkëpunimin dhe i ka ofruar mbështetje dhe përkrahje institucionale togeres Feime Bajrami, që Komuna e Shtimes ta vazhdojë ruajtjen dhe sigurinë në vend.

Ndërsa togere Feime Bajrami ka falënderuar kryetarin Ismajli për pritjen dhe ofrimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Ajo është zotuar se bashkëpunimi në mes të stacionit policor në Shtime dhe Komunës së Shtimes do të vazhdojë edhe në të ardhmen për ta ruajtur sigurinë publike.



Inspeksioni dhe policia në aksion kundër taksistëve ilegalë

Prishtinë, 26 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se që disa ditë inspeksioni, bashkë me Policinë e Kosovës, janë duke zhvilluar aksion për t'i ndalur taksitë ilegale në kryeqytet. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se aksioni do të vazhdojë deri në normalizimin e situatës. "Që disa ditë inspeksioni, bashkë me Policinë e Kosovës, është në aksion intensiv për t'i ndalur taksitë ilegale. Sot në disa pika statike dhe lëvizëse për ta lehtësuar komunikacionin. Aksioni do të vazhdojë deri në normalizimin e situatës", ka shkruar Ahmeti.

Nga 1 marsi shpenzimet e varrimit për therandasit i mbulon komuna

Therandë, 26 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka nënshkruar një marrëveshje me bashkësitë fetare, sipas së cilës, shpenzimet e varrimit do të mbulohen nga kjo komunë. Muharremaj, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, ka bërë me dije se 200 euro do të jetë shuma për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për një familje. "Tash e tutje Komuna e Suharekës do t'i mbulojë shpenzimet për ritet fetare dhe ceremoninë e varrimit për çdo qytetar të vdekur. Sipas një marrëveshje të mirëkuptimit për financim, që është nënshkruar sot me përfaqësues të komuniteteve fetare në Komunën e Suharekës, kryetarit të Bashkësisë Islame, Halim Shehut dhe priftit të Bashkësisë Katolike, Don Mikel Sopit, Komuna e Suharekës do të mbulojë shpenzimet për ceremonitë e varrimeve. Shuma që do të ndihmohen familjet për mbulimin e këtyre shpenzimeve është 200 euro dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 marsi 2019", ka deklaruar Muharremaj.

Ramosaj takon kolonelin Cengiz, flasin për gjendjen e sigurisë në Deçan

Deçan, 26 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka pritur të martën në takim komandantin e JIRD-W, kolonelin Bahadir Ozgur Cengiz, me të cilin ka biseduar për gjendjen e sigurisë në këtë komunë. Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se, pos gjendjes së sigurisë, me kolonelin Cengiz ka biseduar edhe për projektet që janë duke u implemetuar në Deçan. "Sot prita komandantin e JIRD-W, kolonelin Bahadir Ozgur Cengiz. Gjatë këtij takimi biseduam për gjendjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, për projektet të cilat janë duke u implementuar dhe ato të cilat do të implementohen në vazhdimësi. Falënderoj komandantin për gatishmërinë dhe bashkëpunimin!", ka shkruar Ramosaj pas takimit.

Strategjia e rinisë sipas kërkesave dhe nevojave të të rinjve

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë në dëgjimin publik lidhur me draftin e Strategjisë së Rinisë 2019-2023. Strategjia për Rininë 2019-2023 është një strategji gjithëpërfshirëse e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të rinjtë.

Kjo strategji ka për synim përmirësimin e situatës së të rinjve të grupmoshave 15-24 vjeç, duke përfshirë të gjitha palët e interesit si nga sektori qeveritar, po ashtu edhe nga ai joqeveritar.

Strategjia synon ta nxisë bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore, veprimtaria e të cilave lidhet me rininë si dhe ndërmjet organizmave qendrorë dhe atyre komunalë për t'i fuqizuar politikat dhe programet rinore. Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se është i lumtur që sot po diskutojnë për draftin e Strategjisë për Rininë për periudhën pesëvjeçare përmes së cilës do të orientohen politikat rinore. "Kjo politikë rinore fillon me përcaktim të hollësishëm të situatës së rinisë kosovare që nga prezantimi i qëndrimit të të rinjve në 'thirrjen për të bërë ndryshime', duke përfshirë rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në jetën publike, pjesëmarrjen në edukimin joformal dhe informal, në punësim, edukim dhe promovim shëndetësor, në kulturë, sport dhe rekreacion", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se kjo strategji është përcaktuar në tri objektiva: Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive; ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës; dhe mjedis i shëndetshëm dhe i sigurt për të rinjtë.

Aika shtuar se qëllimi kryesor i të gjitha këtyre temave është ideja e përafrimit të të rinjve kosovarë me parimet dhe praktikat më të mira evropiane, në veçanti me nevojat që i ka rinia në vendin tonë. "Temat që i përfshin strategjia kanë të inkorporuar përfshirjen sociale (gjinia, etnia, rinia rurale/urbane dhe grupet e tjera të margjinalizuara) si qasje e përgjithshme që do të merret parasysh gjatë implementimit të aktiviteteve të planifikuara. Ky dokument e ka të paraparë edhe planin e veprimit i cili është i planifikuar me buxhetin e vitit 2019 dhe i cili është lehtë i realizueshëm", ka thënë Gashi.

Koordinatori Hoti bën bashkë liderët e Luginës së Preshevës

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, i ka ftuar të gjithë përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës në Luginën e Preshevës, në një takim të përbashkët në Bujanoc. Në këtë takim u bisedua për rëndësinë e bashkëpunimit pa dallime partiake, për problemet e shqiptarëve në Luginën e Preshevës, me theks të veçantë lidhur me Programin Nacional për Rininë.

Të pranishëm në takim ishin Fatmir Hasani, deputet në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, kryetar i Komunës në Bujanoc, Shqipërim Arifi, kryetar i Komunës në Preshevë, dr. Adnan Salihu, kryetar i Kuvendit të Komunës në Bujanoc, Sami Saliu, kryetar i Kuvendit të Komunës në Preshevë, Ardita Sinani, kryetare e Partisë për Veprim Demokratik në Preshevë, Ragmi Mustafa, kryetar i Partisë Demokratike Shqiptare në Preshevë, Shqipërim Jonuzi, kryetar i Lëvizjes së Progresit Demokratik, Nagip Arifi, kryetar i Partisë Demokratike në Luginë, Galip Beqir, ish-kryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë, Enver Memeti, Këshilli Kombëtar Shqiptar, Armend Aliu, nënkryetar i Komunës së Preshevës e të tjerë.

Në fjalën përshëndetëse, Hoti ka sqaruar qëllimin dhe objektivat e Programit Nacional për Rininë. "Ky Program kontribuon posaçërisht për zhvillimin e dijes, shkathtësive në sport dhe në kreativitet kulturor dhe mendim kritik te nxënësit pa dallim", ka thënë Hoti, duke shtuar se nëpërmjet këtij programi, bashkimi kulturor dhe edukativ vetëm se ka ndodhur.

Të pranishmit biseduan për rëndësinë e takimeve të tilla ku mund të diskutohet hapur dhe në mënyrë konstruktive. Ata e cilësuan këtë takim si një nismë shumë të qëlluar dhe mjaft domethënëse për të ardhmen e Luginës, në veçanti të nxënësve të kësaj ane. Po ashtu, uruan që takime të tilla të përbashkëta të organizohen më shpesh.

Guvernatori Mehmeti takon kryeparlamentarin Talat Xhaferi

SHKUP, 26 SHKURT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, gjatë vizitës në Shkup ka takuar kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi. Guvernatori Mehmeti e ka informuar Xhaferin lidhur me zhvillimet në ekonominë, veçanërisht në sistemin financiar të Republikës së Kosovës, duke potencuar stabilitetin makroekonomik dhe rolin e rëndësishëm të sistemit financiar në mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë së vendit.

Po ashtu, guvernatori Mehmeti ka vlerësuar art bashkëpunimin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës me Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ka shprehur përkushtimin e tij për thellim të mëtejmë të bashkëpunimit në të gjitha fushat e nevojshme për avancimin e veprimtarisë së bankave qendrore.

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për vizitën dhe e ka përgëzuar për punën e mirë të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për sigurimin e një sistemi financiar stabil dhe mbështetje të stabilitetit dhe zhvillimit të ekonomisë së Kosovës.

Presidenti Trump në Vietnam takohet me Kim Jong-un

Hanoi, 26 shkurt - Presidenti amerikan, Donald Trump dhe lideri verikorean, Kim Jong-un, kanë arritur në Vietnam të martën, për të zhvilluar samitin e tyre të dytë. Të dy liderët do të takohen në Hanoi më 27-28 shkurt, për të diskutuar programin bërthamor dhe atë të armëve të Koresë Veriore.

Gjatë këtyre ditëve ka pasur diskutime se të dy liderët mund të pajtohen për t'i dhënë fund edhe zyrtarisht Luftës Koreane, e cila është bllokuar përmes një armëpushimi më 1953.

Trumpi është nisur në kryeqytetin e Vietnamit, Hanoi, me aeroplan derisa Kim ka realizuar këtë udhëtim me tren, përmes Kinës.

Para se të nisej nga Uashingtoni, Trumpi ka thënë përmes një postimi në "Twitter": "Përmes denuklearizimit të plotë, Koreja Veriore do të kthehet shumë shpejt në superfuqi ekonomike. Pa të, do të jetë pothuajse njëjtë. Udhëheqësi Kim do të marrë një vendim të mençur".

Duke folur në një takim me guvernatorët amerikanë në Shtëpinë e Bardhë më 25 shkurt, Trumpi ka parashikuar se takimi do të jetë "i mrekullueshëm".

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo ka thënë për televizionin Fox më 24 shkurt se ai shpreson për arritjen e "hapave funksionalë" në këtë samit.

Dhuna në Venezuelë rrit shqetësimin e kritikëve të politikës amerikane

> Disa kritikë të administratës Trump thonë se politika e tij për Venezuelën po provokon dhunën dhe po parandalon zhvillimin e dialogut paqësor, madje është shumë konfrontuese dhe se do ta vështirësojë edhe më tej arritjen e një zgjidhjeje paqësore të ngërçit politik në atë vend

Uashington, 26 shkurt - Përplasjet e dhunshme dhe vdekjeprurëse në Venezuelë mes mbështetësve të opozitës dhe forcave qeveritare të sigurisë po shtojnë shqetësimin e kritikëve se politika e tanishme amerikane është shumë konfrontuese dhe se do ta vështirësojë më tej arritjen e një zgjidhjeje paqësore të ngërçit politik në atë vend. Përplasjet e kësaj fundjave për ndihmat humanitare kanë rikthyer retorikën për një ndërhyrje ushtarake.

Nënpresidenti amerikan Mike Pence u takua me udhëheqësin opozitar të Venezuelës, Juan Guaido, në Bogota të Kolumbisë, gjatë një takimi të vendeve të Amerikës Latine që mbështesin largimin e presidentit venezuelas Nicolas Maduro. "Për ju president Guaido, kam një mesazh shumë të thjeshtë nga presidenti Trump: jemi me ty 100 %", deklaroi nënpresidenti Pence.

Takimi vjen pasi forcat venezuelase të sigurisë qëlluan me armë ndaj mbështetësve të opozitës që po përpiqeshin të sillnin në vend ndihmat humanitare. Të paktën katër persona u vranë dhe qindra të tjerë u plagosën. Por, Guaido u zotua se njerëzit nuk do të frikësohen. "Sot Venezuela vazhdon të përballet me një emergjencë serioze humanitare që mund të ishte lehtësuar disi nga kjo mbështetje e rajonit", tha Guaido.

Shtetet e Bashkuara dhe mbi 60 vende të tjera kanë njohur Guaidon, kryetarin e Asamblesë Kombëtare, si president të përkohshëm të Venezuelës, pasi Maduro fitoi presidencën vitin e kaluar në një proces zgjedhor që perceptohet gjerësisht të ketë qenë i manipuluar.

Qindra tonë ndihma amerikane të dërguara në kufirin e Venezuelës janë pjesë e një strategjie më të gjerë për ta detyruar Maduron të dorëhiqet. Uashingtoni ka vendosur sanksione ekonomike ndaj industrisë fitimprurëse të karburanteve dhe u ka bërë thirrje udhëheqësve ushtarakë të heqin dorë nga mbështetja për Nicolas Maduron. Por, ai duket se ka ruajtur mbështetjen e ushtrisë dhe i ka denoncuar ngarkesat me ushqime dhe ilaçe, si një përpjekje për të dëmtuar qeverisjen e tij.

Ka njoftime se opozita dëshiron që komuniteti ndërkombëtar të shqyrtojë ushtrimin e forcës për t'i dhënë fund ngërçit politik. Administrata Trump nuk ka përjashtuar ndërhyrjen ushtarake, por shumë aleatë të Shteteve të Bashkuara janë kundër.

Disa kritikë të administratës Trump thonë se politika e tij për Venezuelën po provokon dhunën dhe po parandalon zhvillimin e dialogut paqësor.

"Nëse nuk do të kishin ndërhyrë në këtë mënyrë, do të kishte një lloj kompromisi që do të lindte nga negociatat. Por, nuk e dëshirojnë këtë gjë", thotë Mark Weisbrot, i Qendrës për Studime Ekonomike dhe Politike.

Megjithatë, mbështetësit e presidentit Trump thonë se forcat venezuelase të sigurisë janë përgjegjëse për represionin e dhunshëm në vend dhe për vrasjen e civilëve të pafajshëm. "Njëra palë i ka të gjitha armët - është regjimi i Nicolas Maduros", thotë Roger Noriega, ish-ndihmës Sekretar Shteti për Amerikën Latine.

Shtëpia e Bardhë vendosi të hënën sanksione të reja ndaj katër guvernatorëve venezuelas që akuzohen se bllokuan ngarkesat me ndihma humanitare. Nënpresidenti Pence u bëri thirrje vendeve aleate të Amerikës Latine që t'i ngrijnë asetet e industrisë venezuelase të karburanteve, si dhe të shtojnë presionin diplomatik për të sjellë ndryshime demokratike në Venezuelë.

Kryeministrja May ua ofron ligjvënësve mundësinë e Brexitit pa pakt

Londër, 26 shkurt - Kryeministrja britanike, Theresa May u ka premtuar ligjvënësve britanikë, se do të ketë votim për Brexit pa marrëveshje, apo edhe për shtyrjen e largimit të Britanisë nga Bashkimi Evropian, nëse ata do të kundërshtojnë planin e saj në muajin e ardhshëm.

May ka mbajtur një fjalim para Parlamentit britanik për Brexitin të martën, ndonëse ka pasur shqetësime për ndonjë revoltim të mundshëm nga ministrat që kundërshtojnë Brexitin.

Kryeministrja u ka premtuar deputetëve një votim të mirëfilltë për planin e saj të Brexitit më 12 mars. Ajo ka thënë se nëse ligjvënësit do të kundërshtojnë planin e saj, atëherë ajo do të lejojë votimin për shtyrje të Brexitit si dhe të Brexitit pa pakt.

Sipas saj, një gjë e tillë nënkupton se Britania "mund të largohet pa marrëveshje nga BE-ja, vetëm nëse ka pëlqim të qartë në Parlament për një gjë të tillë".

Megjithatë, ajo ka theksuar se nuk do të dëshironte të shihte Artikullin 50 të zgjeruar, duke paralajmëruar se një gjë e tillë "nuk do ta bënte marrëveshjen më të lehtë".

Artikulli 50 përbën dokumentin, në bazë të të cilit, blloku evropian dhe Britania kanë organizuar punimet për Brexit.

Vendimi për Brexit ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja në krahasim me 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

Britania pritet të largohet nga BE-ja më 29 mars të këtij viti.

Kim Kardashiani bëhet flokëkuqe

Kim Kardashiani tani më është flokëkuqe. Gjatë fundjavës ylli televiziv ka postuar disa fotografi në storiet e "Instagram"-it ku shihet se flokët e saj kanë ngjyrë të kuqe, të hapur. Kardashiani kishte kombinuar flokët e saj me një bluzë të kuqe, grim të syve po me të njëjtën ngjyrë, madje po e shijonte edhe një lëpirëse të kuqe.

Fansat shqetësohen për pamjen e Giuliana Rancicit



Prezantuesja televizive Giuliana Rancic ka shqetësuar fansat me pamjen e saj pas paraqitjes në Oscars. Ajo kishte veshur një fustan të zi që i nxirrte në pah peshën e saj ekstreme të dobët. Kockat e dala jashtë u komentuan më pas nga fansat të shqetësuar për të. Mirëpo, ajo zgjodhi këtë fustan pasi tha se ndihet e veshur sikur për Oscar.

Ariana Grande do të kthehet në Mançester dy vjet pas sulmit vdekjeprurës

Ariana Grande do të kthehet në Mançester dy vjet pas sulmit vetëvrasës ku mbetën të vrarë 22 persona, gjatë performancës në njërin prej koncerteve të saj. Këngëtarja 25-vjeçare do të marrë pjesë në 'Manchester Pride Live' që mbahet më 25 gusht. "Ne jemi me të vërtetë të nderuar që do ta mirëpresim Ariana Granden përsëri në qytetin tonë për të na ndihmuar të festojmë me komunitetin LGBT+", është thënë në deklaratën e organizatorëve të kësaj ngjarje.

Lady Gaga dhe Madonna lënë pas mosmarrëveshjet

Lady Gaga dhe Madonna nuk kanë qenë gjithmonë mike. Keqkuptimet kanë filluar që në vitin 2012 kur Madonna nuk është shprehur mirë për albumin e Gagas, "Born This Way". Megjithatë, në vitin 2017 Gaga është shprehur se ende vazhdon ta admirojë atë si këngëtare, pavarësisht se çfarë mendimi ka Madonna për të.

E jashtëzakonshme

Dëbora jeshile mbulon qytetin

Dëbora ngjyrë jeshile në qytetin rus të Pervouralskit ka ngritur shqetësime rreth efekteve të ndotjes te banorët. Shumica e banorëve mendojnë se është shkaktuar nga ndotja e ambientit, mospastrimi i mbeturinave dhe nga emetimet e një fabrike kromi në qytet. Videot e borës ngjyrë jeshile janë bërë virale në internet.

FOTO E DITES

Princi i Britanisë Harry dhe Meghan vizitojnë tregun në Rabat të Marokut. /AP/

E rrallë

Pasagjeri hedh monedha në motorin e avionit

Një kompani ajrore kineze ka paditur një pasagjeri, i cili shkaktoi më shumë se 21 mijë dollarë dëme, pasi hodhi monedha në motorin e një avioni. Stafi i linjës ajrore, i quajtur ironikisht "Lucky Air", mori në pyetje pasagjerët pasi gjetën dy monedha në asfalt pranë motorit të majtë të avionit para se të niseshin në fluturim më 17 shkurt. Një pasagjer 28-vjeçar, i identifikuar vetëm si "Lu", ka pranuar hedhjen e monedhave në motor të avionit dhe është paditur për anulimin e fluturimit.

BARSOLETA E DITËS

Dy shokë:
- Bir, a e lexove mesazhin që ta dërgova mbrëmë?
- Qata që m'i kishe lyp 50 euro borxh a?
- Po, bir.
- Jo, nuk e kam lexu.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Udhëtimet ju kanë larguar aq shumë nga stresi i përditshëm sa edhe relaksimi i një fundjave do t'jua mbajë gjatë atë buzëqeshjen e qetësisë.

DEMI
Sot e keni nisur ditën me humor të keq dhe kjo gjë do të ndikojë në çdo plan që keni bërë për orët në vazhdim. Duhet ta rregulloni humorin.

BINJAKËT
Të gjithë të lindurit e kësaj shenje sot do të kenë një ditë të qetë dhe plot humor. Në çift ose në punë do të përjetoni surpriza të bukura.

GAFORRJA
Ndjenjat tuaja do të kenë lëkundje të mëdha ditën e sotme dhe vetë ju do të përjetoni çaste tensioni nga pasiguria që ju ka kapur.

LUANI
Nga kokë-fortësia juaj sot do t'ju shpëtojë një rast shumë i mirë financiar që do t'i rregullonte mjaft mirë financat tuaja në të ardhmen.

VIRGJËRESHA
Edhe pse tipa komunikues zakonisht, sot ju ka zënë plogështia dhe nuk doni të bëni asgjë.

PESHORJA
Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktive.



AKREPI
Nëse keni mundësi për të mbaruar punë sot mos e neglizhoni. Koha nuk ju premton për të gjitha projektet tuaja.

SHIGJETARI
Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku nuk do të arrini të zgjidhni gjë.

BRICJAPI
Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.

UJORI
Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot mundohuni të qartësoni disa situata të dyshimta.

PESHQIT
Ditën e sotme duhet të gjeni aleatë të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE | REAL MADRID - BARCELONA 2 | CRYSTAL PALACE - MAN UTD 2 | LIVERPOOL - WATFORD DP1

Rahoveci në festë, nis 'Final 8' dhe përurohet palestra

Qyteti i Rahovecit do të jetë në festë të basketbollit pasi sot fillon "Final 8" i Kupës së Kosovës, i cili do të zgjasë deri më 3 mars. Me këtë rast do të bëhet edhe përurimi i Palestrës

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 SHKURT - Sot (e mërkurë) fillon "Final 8" i Kupës së Kosovës në basketboll. "Final 8" do të mbahet në qytetin e Rahovecit dhe përfundon më 3 mars. Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku, ka përshëndetur punën e madhe që ka bërë KB Rahoveci me mbështetjen e Kuvendit Komunal në përfundimin e punimeve në palestër. "I kanë bërë të gjitha përgatitjet organizative për 'Final 8' të Kupës së Kosovës dhe ne jemi gati që gjithçka të fillojë të mërkurën. E përgëzojmë KB Rahoveci për punën e madhe që e ka bërë jo vetëm për organizimin e këtij aktiviteti, por edhe për përkushtimin dhe vullnetin e madh që e ka treguar për përfundimin e punimeve në palestrën e re, e cila do të inaugurohet në hapjen solemne", ka thënë Dushku, e cila pret nga ekipet pjesëmarrëse dhe tifozët një spektakël të vërtetë basketbolli.

Ndërsa anëtari i bordit të KB Rahoveci, Alban Rama, ka thënë se është shumë i lumtur që palestra është kryer me kohë, kurse pret një organizim të shkëlqyeshëm të "Final 8". "Ne jemi të gatshëm dhe ka filluar edhe shitja e biletave ku do të ketë bileta ditore me çmim dy euro, kurse për tifozët e ekipeve do të ketë bileta të veçanta një euro, pasi ata do të jenë të pranishëm vetëm në ndeshjet e skuadrave të tyre dhe më pas duhet ta lirojnë palestrën", ka thënë Rama, i cili ka treguar se janë në kontakte të vazhdueshme me Policinë e Kosovës, por është siguruar edhe sigurimi privat në mënyrë që gjithçka të shkojë në mënyrën më të mirë.

Basketbollisti i Rahovecit, Rron Grapci, ka thënë se ndihet shumë i lumtur me faktin se do të luajnë në palestrën e tyre. Basketbollisti pejan dëshiron që Rahoveci të nisë me këmbë të mbarë në palestrën e re. "Ne jemi shumë të lumtur që do të luajmë në palestrën tonë dhe para tifozëve tanë. Jemi përgatitur maksimalisht si ekip për të gjitha ndeshjet dhe shpresojmë të fillojmë me këmbë të mbarë në palestrën e re. Synimi është sigurimi i një vendi në finale", ka thënë Grapci, duke pranuar se konkurrenca është shumë e madhe në këtë garë.

Synime të mëdha, si zakonisht, në garën e Kupës ka edhe skuadra e Prishtinës. "Sa i përket 'Final 8' të Kupës së Kosovës, synimet e Z Mobile Prishtinës janë që ta mbroj trofeun e fituar një vit më parë dhe besoj se me potencialin që e kemi në skuadër do të arrijmë ta realizojmë këtë synim", ka thënë Edmond Azemi, kapiten i Prishtinës.

Lidhur me synimet e KB Bashkimi në garën e Kupës, Qëndrim Biraj ka deklaruar: "Në çerekfinale do të luajmë kundër rivalit lokal KB Ponte Prizrenit, të cilin e njohim mjaft mirë, por edhe ata na njohin neve. Shpresojmë se do të fitojmë në këtë përballje dhe më pas të vazhdojmë tutje. Synimet tona janë të shkojmë në finale dhe më pas të shohim se çfarë do të ndodhë".

Sikurse Biraj, optimist është edhe kapiteni i Ponte Prizrenit, Qëndrim Ajazaj. "Jemi përgatitur për duelin me KB Bashkimin. E njohim mjaft mirë si kundërshtar, andaj do të bëjmë përpjekje që të shënojmë fitore dhe kështu të avancojmë tutje në 'Final 8' të Kupës", ka thënë ai.

Në çerekfinale Feronikeli do të jetë kundërshtar i Golden Eagle Yllit, kapitenët Altin Gashi (Ylli) dhe Mustafë Merovci (Feronikel) kanë paralajmëruar se synim e kanë fitoren për të vazhduar tutje në garën e Kupës. Krahas ndeshjeve në konkurrencën e meshkujve, do të zhvillohen edhe ndeshjet në konkurrencën e femrave.

ORARI I "FINAL 8"

Të mërkurën takohen:
14:00 Bashkimi - Prishtina (Femrat/Gjysmëfinalja e II-të)
16:30 Z Mobile Prishtina - Trepça
19:00 Rahoveci - Don Bosko

Të enjten takohen:
16:30 Golden Eagle Ylli - Feronikeli
19:00 Ponte Prizreni - Bashkimi

Të premten takohen:
16:30 Gjysmëfinalja e I-rë
19:00 Gjysmëfinalja e II-të

E shtunë takohen:
19:00 Ndeshja për medaljen e bronztë

Të dielën takohen:
14:00 Finalja në konkurrencën e femrave
17:00 Finalja në konkurrencën e meshkujve

SHKURT

Shaqiri dëshiron të pensionohet në Basel

Ylli shqiptar i skuadrës së Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, në një intervistë për të përditshmen gjermane "Sport 1", ka zbuluar se dëshiron të kthehet te klubi i tij i fëmijërisë, Basel. "Do të ishte shumë mirë të kthehem te Baseli. Kjo do të ishte diçka me të vërtetë shumë e veçantë për mua. Por, nuk e përjashtoj mundësinë që të shkoj në Amerikë ose në Kinë. Mua më pëlqen shumë të shkoj në vende të reja dhe të përjetoj kultura të reja. Por, patjetër, ëndrra ime do të ishte të kthehem në Basel përsëri", ka thënë Shaqiri.

Dy shqiptarë në formacionin e javës në Kroaci

Dy mbrojtës shqiptarë, një i përfaqësueses së Kosovës dhe tjetri i Shqipërisë, kanë siguruar vend në formacionin më të mirë të javës në kampionatin kroat. Amir Rrahmani, mbrojtësi i Dinamos së Zagrebit, shkëlqeu në suksesin 3-0 ndaj Osijekut, ku aktivizohet Kristal Abazaj, ndërsa Ardian Ismajli, pjesë e Hajdukut të Splitit, ishte i pakalueshëm në sfidën e shtëpisë me Gorica që përfundoi në barazim pa gola.

Begolli tregon pse nuk po luan për Llapin

Sulmuesi i krahut, Gentrit Begolli, nuk është paraqitur në dy ndeshjet që Llapi i ka zhvilluar në sezonin pranveror ndaj KEK-ut dhe Feronikelit. Sulmuesi prishtinas ka konfirmuar për "Olle" se mungesa e tij është për shkak të lëndimit. "Jam ende i lënduar dhe pres që shumë shpejt t'i rifilloj përgatitjet", ka thënë Begolli.

FBOUK-ja organizoi turneun e gjashtë me radhë të Kampionatit Ballkanik "Kosova 2019"

Federata e Boulingut të Kosovës (FBOUK) në fundjavë e ka organizuar edicionin e gjashtë me radhë të Turneut në Kampionatin Ballkanik të Boulingut "Kosova 2019", që për katër ditë u zhvillua në qendrën "Albi" në Prishtinë. Pjesëmarrës ishin nëntë shtete: Kosova, Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia, Sllovenia, Greqia, Turqia, Mali i Zi dhe Rumania. Në hapjen solemne i pranishëm ishte edhe presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, anëtari i Komitetit Ekzekutiv të Federatës Evropiane të Boulingut, Marios Nicolaides, si dhe drejtori i sportit në Komunën e Prishtinës, Fitim Rexha. Vendin e parë e zuri Nick Kekesis nga Greqia, në të dytin doli Mariana Meteksinova (Bullgari), ndërsa pozita e tretë i takoi Tihomir Nikolov (Bullgari). Më të suksesshmit ndër garuesit e Kosovës dolën Mirsad Sejdiu dhe Nysret Haziri, të cilët zunë pozitat 13 dhe 15. Pjesëmarrës ishin 38 garues.

Batistuta: Kam refuzuar Realin, Milanin dhe Unitedin

Ish-sulmuesi i Fiorentinas, Gabriel Batistuta, ka zbuluar se ka refuzuar Real Madridin, Milanin dhe Manchester Unitedin. Legjenda argjentinase tregoi si i pëlqente të luante për "Violan" pasi e shikonte si sfidë të konkurronte me skuadrat e mëdha. "Kur nuk më ka pëlqyer të jem njeriu yll pasi sapo të bëhesh fokusi kryesor i ekipit, ju merrni përgjegjësi shtesë. Kam marrë shumë oferta nga Real Madridi, Manchester Unitedi dhe Milani, por preferova të luaja qetësisht për Fiorentinën. Nëse do të shkoja në Madrid do të shënoja 200 gola, por e dija që do të mërzitesha. E njëjta gjë do të më ndodhte edhe te Milani. Nuk kam fituar kurrë ndonjë trofe të rëndësishëm. E konsideroj veten fitues sepse e kam ndihmuar Fiorentinën të konkurrojë me të mëdhenjtë", ka thënë Batistuta.

Alonso rikthehet në Formula 1, teston makinën McLaren

BARCELONË, 26 SHKURT - Dashuria për garat e Formulës 1 do ta rikthejë sot (e mërkurë) në pistë pilotin spanjoll Fernando Alonso. Dy herë kampioni i botës do ta pilotojë makinën McLaren gjatë testeve që do të kryhen në pistën spanjolle të Montmelo (Barcelonë). Alonso ka mbërritur sot në Barcelonë, ku ka takuar stafin e makinës britanike dhe nesër pritet të zbresë në pistë për ta provuar makinën e re. Natyrisht se ky është një test i thjeshtë, pasi piloti spanjoll këtë sezon nuk do të jetë në Botërorin e Formula 1. Këtë vit Alonso fitoi garën 24-orëshe te Daytona në botërorin Endurance. Gjithsesi, përvoja e tij si pilot i Formulës 1 do ta ndihmojë makinën McLaren në përgatitjen e një njëvendëshe të shpejtë e fituese sezonin e ri. Këtë vit McLaren përdor motorin Renault pas "divorcit" me Hondën. Makina britanike këtë sezon do të pilotohet nga Carlos Zainz dhe Lando Norris.

IHF-ja konfirmon: 'IHF Trophy Intercontinental' organizohet në Kosovë

PRISHTINË, 26 SHKURT - Federata Ndërkombëtare e Hendbollit (IHF) ka konfirmuar edhe zyrtarisht se gara prestigjioze "IHF Trophy Intercontinental" do të organizohet në Prishtinë prej 10 deri më 14 prill të këtij viti. Ndeshjet e para të fazës interkontinentale të edicionit 2018\19 të "IHF Trophy" do të luhen të mërkurën më 10 prill, kurse të fundit të dielën më 14 prill. Gara do të zhvillohet për të rinj (U19) dhe juniorë (U21). Fituesit e turneve kontinentalë të "IHF Trophy" nga viti i kaluar e kanë mundësinë që të marrin pjesë në fazën interkontinentale. Kosova kishte fituar në të dyja grupmoshat garën evropiane të organizuar në mënyrë shembullore në Prishtinë në tetor të vitit të kaluar. Për këtë arsye IHF-ja edhe ia besoi Federatës së Hendbollit të Kosovës organizimin e fazës interkontinentale. Nga Afrika pritet të marrë pjesë Nigeria në të dy grupmoshat, ndërsa nga Azia të drejtën e ka Taipei Kinez. Prej Amerikës së Veriut dhe Karaibeve, me të rinjtë pritet të garojë Kanadaja, ndërsa te juniorët ShBA-ja. Prej Oqeanisë do të jetë Zelanda e Re te të rinjtë dhe Australia te juniorët. Prej Amerikës së Jugut dhe Qendrore do të garojë Paraguai në të dy grupmoshat. "Fituesi i grupmoshës së juniorëve në IHF Intercontinental Trophy do të kualifikohet drejtpërdrejt për Botërorin 2019 të juniorëve (U21), që mbahet në Spanjë në korrik", ka konfirmuar Federata Ndërkombëtare. Takimi miqësor ku u bë i ditur lajmi i madh që hap rrugën që Kosova për herë të parë në ndonjë sport ekipor të marrë pjesë në botëror u mbajt më 18 shkurt në selinë e IHF-së në Basel të Zvicrës. Nikoqir i presidentit Eugen Saraçini dhe sekretarit gjeneral Izet Gjinovci ishte presidenti i IHF-së dhe miku i madh i Kosovës, Hassan Moustafa.

Lakersat dhe Spursi në krizë, Golden State dominon në Perëndim

MEMPHIS, 26 SHKURT - Kampionët e Golden States fituan 121-110 ndaj Charlottes në fushën e kësaj të fundit, duke ruajtur pozitat në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Të gjithë titullarët e Warriorsit realizuan mbi 10 pikë, me Thompsonin që ishte shënuesi më i mirë, autor i 26 pikëve. Fiton edhe Houstoni, 119-111 ndaj Atlantës, duke qenë forca e pestë në Perëndim. Tjetër ndeshje e mirë e Hardenit që e mbylli takimin me 28 pikë. Nuk po kalojnë mirë lakersat dhe San Antonio që pësuan humbje. Lakersat u mundën 110-105 nga Memphisi, humbje që ndërlikon edhe më shumë pozitat e ekipit kalifornian, jashtë zonës së "play-off"-it. Conley me 30 pikë ishte shënuesi më i mirë për Memphisin, duke i bërë të pavlefshme 24 pikët, 12 rebounde e 11 asistime të LeBron Jamesit, që realizoi një "triple double", raporton "Telesport"-i. Ndërsa San Antonio u mund 101-85 nga Brooklyn që, gjithashtu, ndodhet në pozita të vështira në Perëndim. Russelli realizoi 23 pikë për vendësit, ndërsa për Spursin u dallua Aldridge me 26 pikë e 10 rebounde, por që mbetën për statistikë. Fiton Clippersi që, në fushën e vet, mundi 121-112 Dallasin, ndeshje e ekuilibruar në shumicën e kohës e ku diferencën e bëri Harelli me 32 pikë. Në sekondën e fundit fiton Philadelphia që, falë 29 pikëve të Harrisit, mundi 111-110 New Orleansin.

REZULTATET

Charlotte - Golden State	110-121
Cleveland - Portland	110-123
Detroit - Indiana	113-109
Brooklyn - San Antonio	101-85
Miami - Phoenix	121-124
Chicago - Milwaukee	106-117
Houston - Atlanta	119-111
Memphis - Lakers	110-105
Minnesota - Sacramento	112-105
New Orleans - Philadelphia	110-111
Clippers - Dallas	121-112

SHKURT

Memushaj, rekordmen në Serinë B

Ledian Memushaj është lideri i heshtur i Pescarës. Ka luajtur 23 ndeshje dhe ka dhënë 7 asistime për ekipin e "delfinëve" duke kontribuuar në objektivin për t'u rikthyer në Serinë A. Mesfushori 32-vjeçar i Kombëtares shqiptare ka luajtur 23 ndeshje nga 24 të mundshme duke qenë lojtari i dytë me më shumë minuta të grumbulluar në skuadrën italiane. Vetëm Mankuso me 2 074 minuta ka arritur ta parakalojë. Shqiptari deri tani ka luajtur 2 066 minuta. Të dy janë futbollistët më të rëndësishëm në skuadër, i pari përveçse ka luajtur kaq shumë, ka arritur të shënojë edhe 15 gola. Këtë vit Memushaj ende nuk ka gjetur rrugën e rrjetës, por ka dhënë 7 asistime dhe ekipi i tij ka marrë gjithmonë rezultate pozitive. Pesë fitore dhe 1 barazim në 6 ndeshje, që e bëjnë vlonjatin fatsjellës për ekipin e drejtuar nga Xhuzepe Pilon.

Allegri në qershor largohet nga Juve

Ish-trajner i Massimiliano Allegrit te Perugia, Giovanni Galeone, është sot e kësaj dite mentori i teknikut të bardhezinjve. Për mediet italiane Galeone ka dhënë mendimin lidhur me të ardhmen e Allegrit. "Sido që të përfundojë Liga e Kampionëve, mendoj se aventura e tij te Juventusi ka marrë fund dhe në Itali s'ka klube të tjera të cilave mund t'i bashkohet. Verën e kaluar refuzoi Arsenalin, Chelsean, Unitedin dhe Realin për ta fituar Ligën e Kampionëve me Juven: edhe nëse nuk e fiton, s'është diçka e madhe. Nuk e ka si detyrë vetëm sepse ka Ronaldon. Nëse triumfon, megjithatë, ia dedikon Sakit. Juventusi duhet të besojë te përmbysja me Atleticon", ka thënë Galeone.

Modriqi vazhdon me Realin

Luka Modriq po lidhet me një largim nga Real Madridi, por që lojtari duket se përfundimisht ka vendosur për të ardhmen e tij. Mesfushori është duke u kërkuar me ngulm nga Interi, mirëpo duket se një gjë e tillë nuk do të ndodhë. Modriqi ka pranuar ta rinovojë kontratën me Real Madridin, duke e refuzuar edhe një herë kalimin te "Nerazurët".

Reusi rikthehet nga lëndimi

Borussia Dortmundi është duke luftuar për titull me Bayern Munchenin. Diferenca e kësaj skuadre me Bayenrin është tri pikë, kurse trajneri Lucien Favre ka marrë një lajm të mirë, pasi nga lëndimi është rikthyer kapiteni Marco Reus. 29-vjeçari ka lënë pas dëmtimin që pësoi në Kupën e Gjermanisë ndaj Werder Bremenit, dëmtim që e la jashtë në disa sfida të rëndësishme, përfshirë edhe duelin e parë në raundin e 1/8-ave në Ligën e Kampionëve ndaj Tottenham Hotspurit.

Portieri Kepa dënohet dhe kërkon falje

Kepa Arrizabalaga nuk pranoi te zëvendësohej në fund të ndeshjes në finalen e Kupës së Ligës ndaj Manchester Cityt, duke krijuar një ngjarje të pazakontë me veprimin e tij. Trajneri Muarizo Sarri dhe stafi i tij nuk e përmbajtën dot mllefin ndaj portierit në ato çaste. Së fundmi ka reaguar edhe Klubi i Chelseat, duke e gjobitur me heqjen e një pagë javore. Nuk ka sanksione të tjera, siç mund të ishte edhe dënimi me disa ndeshje. Argumenti i portierit ishte se gjithçka ishte një ngatërresë. Stafi mjekësor pati dhënë lejen se ai mund të luajë, por Sarri nuk mendonte kështu. Gjithsesi ai kërkoi falje pas kësaj situate tejet të ndërlikuar. "Megjithëse ishte një keqkuptim, unë kam bërë një gabim të madh dhe e marr përsipër", ka thënë Kepa.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në

Shitjen 44

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:

Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: **e mërkurë 27 shkurt 2019**, prej orës **10:00 - 12:00**,

Vërejtje: Njësitë në vijim janë tërhequr nga Shitja 44 e Aseteve në Likuidim:

Njësia nr.77: NSH Lavërtari-Blegtori - Tokë bujqësore në Trepetincë 2
Njësia nr.88: NSH Lavërtari-Blegtori-Tokë bujqësore në Trepetincë 1

DORËZIMI I OFERTAVE

në Sallën e konferencave të Hotelit Grand

Si duhet të përgatitet oferta:

OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).

Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një **pliko (zarf)** të madh e të mbyllur – shih më poshtë: **ZARFI 3**
Brenda këtij zarfi (ZARFI 3), ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura: ZARFI 1 dhe ZARFI 2

ZARFI 3

OFERTA PËR SHITJEN E ASETEVE NR.....
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

ZARFI 1

INFORMATA SHTESË PËR OFERTËN
(Shitja e Aseteve nr. ....)
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

ZARFI 2

ÇMIMI I OFERTËS
(Shitja e Aseteve nr. ....)
Numri i njësisë: .....
Përshkrimi i njësisë: .....

Dokumentet në vijim duhet të vendosen brenda zarfit
"Informata shtesë për ofertën"

1. Dokumentet e cekura në **pikën 8.6. ii** të Rregullave të Tenderit.
2. Origjinalin e formularit për dorëzimin e ofertës - **"SHTOJA C"**, e plotësuar dhe nënshkruar nga ofertuesi.
3. Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e AKP-së.
4. Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së.


SHTOJCA "B" - PASQYRA E ÇMIMIT TË OFERTËS

Emri i Plotë i Ofertuesit: Filan Fistoka
Numri i njësisë dhe emri i asetit/subjektit të ri: Njësia nr. XX (emri i njësisë)
SHAL numër: SHA 44

ÇMIMI I OFERTËS – SHËNO ÇMIMIN E OFERTËS QË JU SYNONI TË PAGUANI PËR SUBJEKTIN RI NË SHIFRA

Qindra Milionë	Dhjetëra Milionë	Milionë	Qindra Mijëra	Dhjetëra Mijëra	Mijëra	Qindra	Dhjetëra	Njësi
			1	0	0	0	0	0

NË FJALË: Njëqindmijë euro

SHËNIME:
- NË RAST TË ÇFARËDO MOSPËRPUTHJE NË TABELË, NË MES TË SHUMËS SË PARAQITUR ME SHKRONJA DHE SHUMËS SË PARAQITUR ME SHIFRA DO TË MBIZOTËROJ SHUMA E PARAQITUR NË SHKRONJA DHE DO TË TRAJTOHET SI ÇMIMI I OFERTËS.
- NË RAST SE SHUMA E PARAQITUR ME SHIFRA DHE SHUMA E PARAQITUR ME FJALË JANË TË PALEXUESHME DHE/OSE TË PAKUPTUESHME, OFERTA E OFERTUESIT DO TË DISKUALIFIKOHET.
- NUK LEJOHET ASNJË NDRYSHIM/PËRMIRËSIM I ÇMIMIT TË OFERTËS.
- AGJENCIA DO TË SHPALL TË PAVLEFSHME OFERTËN E DORËZUAR E CILA KA NDRYSHIM/PËRMIRËSIM TË ÇMIMIT TË OFERTËS SIPAS NENIT 13.1 TË KËSAJ RREGULLOREJE.
- NË RAST SE OFERTUESI NUK PARAQET ÇMIMIN E OFERTËS, EDHE ME FJALË EDHE ME SHIFRA, OFERTA E TIJ DO TË DISKUALIFIKOHET.

Emri & Mbiemri: Filan Fistoka Data: XXXXXX
Nënshkrimi: Fistoka

Ky nënshkrim po ashtu konfirmon se ofertuesi pranon shënimet më lartë dhe pajtohet që të obligohet me deklaratën e bërë këtu.
Vërejtje: Ju lutem kini parasysh se të gjitha fushat duhet të jenë të plotësuara. Në rast se ndonjëra nga informatat mbetet e paplotësuar, oferta do të diskualifikohet.

KUJDES, TË PLOTËSOHEN TË GJITHA FUSHAT!!

* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 44 të Aseteve** janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat në formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**

Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.

LLOGARITË BANKARE PËR LIKUIDIM:

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro) duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000173
Depozita e ofertës duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000076

Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevci Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë
tel: + 383 (0) 38 500 400 lok. 2004, 1090,1105, ose 1152 / fax: + 383 (0) 38 248 076
e-mail: shitja@pak-ks.org ose **sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org**

TrafikuUrban

N.P.K "Trafiku Urban" SH.A., në bazë të nenin 25 paragrafi 2 pika (h) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Nr. 03/L-087, ndryshim plotësimin e Ligjit për NP-të Nr.04/L-111 neni 13, vendimin e Komisionit të Auditimit nr.789 të datës 26.02.2019 shpall këtë:

K O N K U R S

Pozita e punës: Zyrtar/e për Auditim të Brendshëm (1 pozitë).
Kohëzgjatja e kontratës: 3 vite, me mundësi vazhdimi.
Orari i punës: I plotë.
Vendi: Prishtinë
Detyrat e përgjithshme:

Bartësi i vendit të punës mbikëqyre dhe koordinon aktivitetet e auditimit, të buxhetit , të hyrave, shpenzimet, prokurimit, depos, stafit dhe aktiviteteve operative që njësitë menaxhuese të ndërmarrjes i realizojnë gjatë aktiviteteve operative në menaxhimin e N.P.K "Trafiku Urban" SH.A.
Vlerëson efektivitetin e punës dhe zbatueshmërinë konform me procedurat dhe rregullat e Trafikut Urban .
Bartësi i vendit të punës i raporton Komisionit të Auditimit.

Detyrat specifike dhe përgjegjësitë:

- Aplikon sistemin e kontrollit-auditimit të brendshëm të pranueshëm dhe të efektshëm,
- Të vëzhgojë dhe të kritikoj politikat dhe praktikat që kanë të bëjnë me kontabilitet, procedurat, administratën dhe ruajtjen e mjeteve dhe të pasurisë së TU.
- Siguron që aktivitetet e TU të jenë në harmoni me Statutin dhe aktet tjera rregullative, ligjore dhe urdhëresat nga menaxhmenti.
- Monitoron dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të Aksionarëve, Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit të TU-së në linjë me objektivat e Menaxhmentit.
- Kryen kontrolla të brendshme sipas planit të Auditimit të Brendshëm të aprovuar nga Komisioni i Auditimit.
- Diskuton rezultatet e auditimit të kryer me personin përgjegjës të departamentit apo njësisë dhe jep këshilla-udhëzime rreth veprimeve që duhet ndërmarrë për përmirësimin e gjendjes.
- Përpilon raporte të shkruara dhe i'a paraqet për aprovim Komisionit të Auditimit të Trafikut Urban me qëllim të përcjelljes së mëtutjeshme të tyre tek përgjegjësit e departamenteve apo njësive të audituara.
- Përgatitë raport mujor, vjetor rreth punëve operative të Auditimit të brendshëm të TU.
- Mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e ndryshme të veprimtarisë me qëllim të arritjes së një vlerësimi objektiv
- Analizon praktikat dhe procedurat e kontabilitetit të Trafikut Urban si dhe propozon modifikimin apo përshtatjen e tyre sipas standardeve të kontabilitetit në vend.
- Përveç detyrave dhe përgjegjësive të cekura performon edhe në detyra tjera të kërkuara nga Kryeshefi dhe Komisioni i Auditimit të Trafikut Urban.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Të përmbushë kriteret për zyrtarë të ndërmarrjes sipas nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- ZAB duhet të posedojë diplomë universitare nga Fakulteti Ekonomik;
- Të jetë ekspert i certifikuar në kontabilitet sipas Ligjit;
- Duhet të ketë përvojë të punës së paku 3 vite në pozita të larta udhëheqëse apo menaxhuese;
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi, me theks në Ligjin për NP, Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe ligjet të tjera që kanë të bëjmë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave;
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikuese;
- Njohja e gjuhës angleze në shkrim dhe në të folur;
- Aftësi organizative dhe koordinuese;
- Preferohet të ketë certifikata të trajnimeve gjatë karrierës;

Dokumentacioni i kërkuar:
Kandidati, duhet t`i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: puncsimi@trafikurban-pr.com;
1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html;
2. Një deklaratë nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe nenit 17.2 *(forma mund të shkarkohet nga ueb faqja e TRAFIKUT URBAN* http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-deklarata-shq.html ;
3. Letër motivuese;

4. Dëshmi mbi shkollimi;
5. Certifikatë si ekspert i kontabilitetit sipas ligjit;
6. Dëshmi mbi përvojën e punës;
7. Kopja e letërnjoftimit;
8. Kandidati së bashku me aplikacionin duhet të dorëzojnë edhe vërtetimin nga gjykata kompetente se i njëjti nuk është nën hetime – jo më të vjetër se 6 muaj.
-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.
Informata të përgjithshme:
-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.
-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
Mënyra e Aplikimit:
Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit : punesimi@trafikurban-pr.com.
Konkursi është i hapur nga data **17.02.2019** dhe përfundon më datë **13.03.2019** në ora 24:00.

Kryesuesi i Komisionit të Auditimit
Genc Broqi

Prishtinë, më 26.02.2019

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA

DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.156 datë 25.02.2019

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212 , nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068,Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik,Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

1.SHFMU"Destan Bajraktari"-Suharekë

Vendi i punës:Punëtor teknik-ndihmës

Detyrat dhe përgjegjësitë për punëtor ndihmës:
- ✓ Përgjigjet për pastrimin e gjithë hapësirave të shkollës,pajisjeve të shkollës dhe objekteve përcjellëse,
- ✓ Përgjigjet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e oborrit të shkollës në aspektin e mbajtjes së ambientit dhe kultivimin e gjelbërimit,
- ✓ Me punën dhe angazhimin e vet të krijojë një ambient të pastër,të kulturuar dhe të përshtatshëm për zhvillimin normal të procesit mësimor
- ✓ Kryen edhe detyra të tjera të cilat ia cakton drejtori, zv. drejtori ose zyrtari administrativ.

Kualifikimi:Shkolla fillore
Paga(koeficienti):4

-Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.
-Kërkesës i bashkëngjiten këto dokumente:
-Dëshmi mbi kualifikimin(fotokopje),
- Ekstrakti i lindjes
-letërnjoftimi fotokopje.
-dëshmi mbi përvojën e punës(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.Kandidatët e përzgjedhur në listen e ngusht do t'i nënshtrohen testit dhe intervistës.
Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë .
Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.
Afati i konkurrimit 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bytyqi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA

DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05br .156 datum: 25.02.2019

Na osnovu člana 8. Zakona o radu 03 / L-212, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosova br. 03 / L-068, Administrativno uputstvo br.07 / 2017 o regulisanju procedure za zasnivanje radnnog odnosa u javnom sektoru, Opštinska direkcija za obrazovanje objavljuje :

K O N K U R S

Za popunu slobodnih radnih mesta

2. OSNŠ "Destan Bajraktari" Suva Reka
Radno mesto: Tehnički radnik/pomočni
-Dužnosti i odgovornosti za pomoćno osoblje:
-Odgovora za čišćenje svih prostorija škole, školske opreme i pratećih objekata,
-Odgovora za čišćenje i održavanje školskog dvorišta u smislu očuvanja životne sredine i negovanja zelenila,
-Sa svojim radom i angažovanjem stvoriti čisto, kultivisano i prikladno okruženje za normalan proces učenja.
Izvršava druge dužnosti koje odredi direktor,zamenik direktora ili administrativni službenik.

Kvalifikacija: Osnovna škola
Plata (koeficijent): 4
Potrebna dokumentacija za prijavu na konkurs:
-Obrazac za prijavu(zahtev)koji popunjava kandidata
-Dokaz o kvalifikaciji (fotokopija),.
-Izvod rođenih
-Lična karta (fotokopija)
-Potvrda o radnom iskustvu (ako ga poseduje)
-Kompletirana dokumenta se dostavljaju fotokopirana, dok se originalna dokumenta predstavljaju u intervjuu. Komisija neće razmatrati nekompletirana i dokumenta koja se predaju nakon isteka utvđenog roga.Izabrani kandidata iz uže liste biće podvrgnuti testiranju i intervistiranju.
Kontaktirače se samo izabrani kandidati iz uže liste
Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Kancelariji za prijem u opštini Suva Reka.
Rok za podnošenje prijave je 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja u javnim medijima. informisanja.

Direkcija za obrazovanje

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)- Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Sektori i Personelit QKUK.

Në bazë të nenit 8 parag. 1 e 2 dhe nenit 10 parag. 6 e Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 13 pika 1 dhe 3 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Qendra Klinike Universitar e Kosovës, (SHSKUK); nenit 5, parag. 1 e 2 e Rregullores Nr. 1003/2016 mbi marrëdhënien e punës; Strukturës Organizative nr. 1576/2 të datës 08.11.2018, si dhe Kërkesës të datës 19.02.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, shpall:

K O N K U R S

Nr.	Titulli i Vendit të punës	Departamenti/Sektori	Sa pozita
1.	Inxhinier të Arkitekturës	Sektori për Infrastrukturë dhe Investime Kapitale	4 pozita
2.	Inxhinier të Ndërtimtaris		2 pozita
3.	Inxhinier të Elektros		1 pozitë
4.	Inxhinier të Makineris		1 pozitë

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e i/e projekteve dhe investimeve kapitale në QKUK,

Koeficienti i pagës: (8.4)
Norma e punës: 40 orë në javë
Kontrata: Për punë dhe detyra specifike (120 ditë)
Raporton: Shefit të Sektorit për Infrastrukturë dhe Investime Kapitale SHSKUK
Nr. i Referencës: SHSKUK - 09/2018-2/8

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve të SHSKUK-së
- Organizon punën në mirëmbajtjen, riparimin, sanimin e defekteve të mundshme nga lëmia e ndërtimtarisë.
- Përpilon planin për realizimin e detyrave prioritare nga lëmia e ndërtimit.
- Përpilon paramasa dhe parallogarit me projekte nga lëmia përkatëse.
- Bën mbikëqyrjen e punëve ndërtimore që zhvillohen në SHSKUK nga ana e Operatorëve Ekonomik.
- Jep sugjerimet e nevojshme profesionale në lidhje me prioritetet e intervenimeve në meremetimin e objekteve ndërtimore.
- Përpilon nevojat e furnizimit me material teknik nga lëmia e vet.
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e objekteve të SHSKUK-së, dhe në bashkëpunim me Shefin e MOH-it organizon punën në evitimin e defekteve të ndryshme.
- Propozon zgjidhje dhe jep sugjerime profesionale në lidhje me zbatimin e rregullave të mbrojtjes në punë dhe zbatimin e standardeve teknike.

Përvoja: së paku (3) tri vjet pune ne lëmin përkatëse

Të plotësohen edhe më këto dokument:

- Diplomë Universitare – Inxhinier i Arkitekturës ose Baçelor i Arkitekturës,
- Certifikata nga libri amzë i të lindurve,
- Letërnjoftimi i fotokopjuar,
- Njohja e gjuhës angleze – e dëshirueshme,
- Njohja e kompjuterit (word dhe exel) – dëshmi,
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësimit, rekomandime, etj.
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësimit, rekomandime, etj.
- **Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.**
- Origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave për kohën sipas këtij konkursi.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e shpalljes në njërën nga gazetat ditore

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në Sektorin e Personelit të QKUK-së, Objekti i ri i Administratës. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës.

Kontaktet me telefon mund t'i bëni në 038/512-667

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK) - Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Kadrovska Služba

Prema članu 8, tačka 1 i 2, član 10 tačka 6 Zakona o radu br. 03/L-212; člana 4 Administrativno Uputstvo (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru; člana 13. tacka 1 i 3. Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), članu 5 tačka 1 i 2 Odredbe br. 1003/2016 o Radnim Osnosima; Organizaciona Struktura u UBKSK br. 1576/2 datë 08.11.2018 i Zahteva od dana 19.02.2019, Generalni Direktor UBKSK, raspisuje:

K O N K U R S

Br.	Naziv radnog mesta	Departament/Sektora	Koliko poz.
1.	Inxhinier të Arkitekturës	Sektor za infrastrukturne i Kapitalne investicije	4 pozicije
2.	Inxhinier të Ndërtimtaris		2 pozicije
3.	Inxhinier të Elektros		1 pozicija
4.	Inxhinier të Makineris		1 pozicija

Institucije: Universitetski Bolnicke i Klinicke Sluzbe Kosova. (UBKSK)

Funkcionalna kategorija-koeficijenat: (4.8)
Radno Vreme
Ugovor: . Po zakonima koji su na snazi, Specifični zadaci i obaveze za 120 dana,
Izveštava: Šefu Sektora za infrastrukturu i Kapiale Investicije UBKSK
Referentni br. UBKSK - 09/2019-02/8

1. Serviser u Jedinice Remonta Kolica i druge Ortopedska Oprema / Osmnovna Škola.

Opis posla:

oprema
.

Ključni zadaci:

• Da sprovede sve profesionalne aktivnosti koje su specifične za profesiju i odeljenja gde radi.
• Da doprinese stvaranju sigurnog okruženja gde radi.
• Da bi se osigurala dobra komunikacija tokom primopredaje, nakon sata i tačnih podataka za alate koji rade stalno u svako radnog vremena njegovog / njenog rada.
• Da doprinosi održavanju čistoće i higijene u radnom okruženju

Ključne odgovornosti:

• Koristiti i pravilno, bezbedno održavanje na svim uređajima.
• Da bi se pomoglo u razvoju pisane procedure kojima se rukovodi u rad servisera.
• Učestvuje u tim sastancima kada je to neophodno.
• Učestvuje u aktivnostima koje organizuju pojedine programe jedinica u cilju razmene znanja i informacija između osoblja koje radi.
• Održavanje kompletne konfidencialiteta pitanja koja se odnose na rad ustanova, osim ako ona / on je ovlašćen u pisanoj formi, u skladu sa institucionalne politike.
• Biti registrovani i imaju dozvolu za relevantnim nadležnim organima.
• Obavlja i druge poslove u skladu sa nadzornika da obezbedi visoku efikasnost na poslu.

Uslovi potrebni za Serviseru - fotokopije:

- Diploma Osnovne Škole;
- Rodjeni izvod;
- Certifikat licenciranja za radu;
- Fotokopie lične karte;
- Posebna obuka za popravku kolice, će imati prednost;
- Radno iskustvo u popravku / servisiranja kolice ima prioriteta;
- Kandidati koji su odbijeni, dokumentacija ne vrati za to što su fotokopje;
- Takođe može da donese i druge dokaze o trening, preporuke, itd;
- Će biti potrebna originalna ovih dokumenata ili notarom samo kada je kandidat pozvan da radi.

Iskustvo: Godinu dana staža u odgovarajućoj smeru

